FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 229

Tiranë – E mërkurë, 10 dhjetor 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 64/2025, datë 6.11.2025	Për barazinë gjinore.....	28727
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 733, datë 3.12.2025	Për miratimin e planit të veprimit të Agjendës Digjitale për Arsimin 2025–2030, duke përfshirë standardet për arritjen e kompetencës digjitale.....	28749

LIGJ
Nr. 64/2025

PËR BARAZINË GJINORE[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Ky ligj garanton, mbron dhe promovon arritjen e barazisë gjinore si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë.

2. Ky ligj rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në të gjitha fushat e jetës publike dhe private për arritjen e barazisë gjinore plotësisht dhe në mënyrë efektive, ligjërisht dhe në praktikë, si dhe trajtimit të barabartë, pavarësisht përkatësisë gjinore, përmes mbrojtjes, mundësive të barabarta për ushtrimin e të drejtave dhe gëzimin e të mirave dhe shërbimeve, pjesëmarrjes, përfaqësimit dhe ndihmesës në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është:

a) të sigurojë të drejtën e çdo individi për barazi gjinore dhe për mbrojtje efektive nga diskriminimi gjinor dhe pabarazitë gjinore për shkak të përkatësisë së shumëfishtë në jetën publike dhe private, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi;

b) të përcaktojë për të gjitha fushat e veprimtarisë, përfshirë edhe fushat sipas këtij ligji, masat e përgjithshme dhe të veçanta të bazuara në nevojat dhe prioritetet e ndryshme gjinore, me qëllim përmirësimin, nxitjen dhe realizimin e barazisë gjinore në shoqëri;

c) të përcaktojë autoritetet përgjegjëse për zhvillimin dhe nxitjen e barazisë gjinore në shoqëri dhe detyrimet e tyre për arritjen e barazisë gjinore, monitorimin dhe vlerësimin e arritjes së saj.

Neni 3
Parimet themelore

1. Ky ligj bazohet në parimin e barazisë, të mosdiskriminimit dhe në parimet e tjera të parashikuara nga Kushtetuta, Konventa "Për

[1]Ky projektligj është përafruar pjesërisht me:

- Direktivën (BE) 2019/1158 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për balancën punë–jetë për prindërit dhe kujdestarët" dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 2010/18/BE. Numri CELEX 32019L1158, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 188, datë 12.7.2019, faqe 79–93.

- Direktivën e Këshillit 92/85/KEE, datë 19 tetor 1992, "Mbi futjen e masave për të inkurajuar përmirësimet në sigurinë dhe shëndetin në punë të punëtoreve shtatzëna dhe punëtoreve që kanë lindur së fundmi ose që janë duke ushqyer me gji", e ndryshuar. Numri CELEX 31992L0085, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 348, datë 28.11.1992, faqe 1–7.

- Direktivën e Këshillit 79/7/KEE, datë 19 dhjetor 1978, "Mbi zbatimin progresiv të parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në çështjet e sigurimeve shoqërore". Numri CELEX 31979L0007, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 6, datë 10.1.1979, faqe 24–25.

- Direktivën 2010/41/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 7 korrik 2010, "Mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave të angazhuar në një aktivitet të vetëpunësuar" dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 86/613/KEE. Numri CELEX 32010L0041, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 180, datë 15.7.2010, faqe 1–6.

- Direktivën 2006/54/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 5 korrik 2006, "Mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit". Numri CELEX 32006L0054, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 204, datë 26.7.2006, faqe 23–36.

- Direktivën e Këshillit 2004/113/KE, datë 13 dhjetor 2004, "Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave në aksesin dhe furnizimin me mallra dhe shërbime". Numri CELEX 32004L0113, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 373, datë 21.12.2004, faqe 37–43.

- Direktivën (BE) 2022/2381 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23 nëntor 2022, "Për përmirësimin e balancës gjinore midis drejtorëve të kompanive të listuara dhe masat e lidhura me to". Numri CELEX 32022L2381, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 315, datë 7.12.2022, faqe 44–59.

- Direktivën (BE) 2023/970 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 10 maj 2023, "Për të forcuar zbatimin e parimit të pagës së barabartë për punë të barabartë ose punë me vlerë të barabartë midis burrave dhe grave përmes transparencës së pagave dhe mekanizmave të zbatimit". Numri CELEX 32023L0970, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 132, datë 17.05.2023, faqe 21–44.

- Direktivën (BE) 2024/1385 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14 maj 2024, "Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje". Numri CELEX 32024L1385, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 2024/1385, datë 24.5.2024.

eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave", Konventa e Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje", Konventa 190 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës "Mbi dhunën dhe ngacmimin në botën e punës", si dhe të gjitha aktet e tjera ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Dispozitat e këtij ligji në asnjë rast nuk interpretohen apo zbatohen si kufizuese të garancive për arritjen e barazisë gjinore, të shprehura në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe *acquis* të Bashkimit Evropian për barazinë gjinore.

3. Pretendimet për shkelje të rregullave të barazisë gjinore, që, sipas rastit dhe kompetencave, paraqiten pranë subjekteve publike dhe private, pranë organeve të drejtësisë apo institucioneve të tjera, shqyrtohen mbi bazën e parimit se barra për të provuar se faktet e paraqitura nuk përbëjnë shkelje të këtij parimi i përket të padituritt dhe subjektit/eve mbi të cilët bie ky pretendim.

4. Nuk përbëjnë diskriminim për shkak të gjinisë rastet kur subjektet publike dhe private marrin masa sipas këtij ligji, përfshirë edhe dispozita ligjore të ndërmarra nga institucionet publike, në përputhje me kompetencat e tyre kushtetuese dhe ligjore, që synojnë përshpejtimin e vendosjes së barazisë faktike gjinore. Këto masa pushojnë së ekzistuari sapo të jenë arritur objektivat e barazisë gjinore për të cilët janë krijuar.

5. Ky ligj mbështetet në parimin e sigurimit të aksesit dhe përfitimit të barabartë, pavarësisht përkatësisë gjinore në shërbimet publike dhe private.

6. Rregullat e parashikuara në këtë ligj zbatohen në mënyrë gjithëpërfshirëse pavarësisht përkatësisë gjinore.

Neni 4
Përkufizime

1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Barazi gjinore" janë të drejta, përgjegjësi, mundësi, pjesëmarrje dhe përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në të gjithë diversitetin e tyre, në të gjithat fushat e jetës, si dhe mundësi të barabarta për të gëzuar të drejtat dhe për të përmbushur detyrimet në shoqëri, duke përfituar njëlloj nga arritjet dhe zhvillimet e shoqërisë, në respektim të dallimeve biologjike, shoqërore, kulturore, interesave, nevojave dhe prioriteteve të grupeve të ndryshme sipas përkatësisë gjinore;

b) "Buxhetim i përgjigjshëm gjinor ose buxhetim gjinor" është qasja për të integruar në mënyrë sistematike objektivat e barazisë gjinore në politikat qeveritare, planifikimin, buxhetimin, monitorimin, vlerësimin dhe auditimin dhe që synon të nxjerrë në pah ndikimin e buxhetit (të ardhurat dhe shpenzimet) mbi gratë dhe burrat, dhe të rregullojë ose të orientojë burimet për të siguruar që gjinitë të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga burimet e qeverisë, si dhe mjeti për të siguruar që angazhimet e ndërmarra politike për arritjen dhe respektimin e barazisë gjinore nga qeverisja të reflektohen dhe të realizohen në praktikë nëpërmjet buxhetit;

c) "Diskriminim për shkak të gjinisë" është çdo dallim, përjashtim, preferencë ose kufizim mbi baza gjinore, që ka për qëllim dhe/ose sjell si pasojë dëmtimin, mosnjohjen, mosgëzimin dhe mosushtrimin në mënyrë të barabartë nga secila gjini të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligje në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile, të aksesit në drejtësi dhe në çdo fushë tjetër;

ç) "Dhunë dhe ngacmim/shqetësim" i referohet një numri sjelljesh dhe praktikash të papranueshme ose kërcënimeve për kryerjen e tyre, qoftë kjo edhe një ndodhi e vetme ose e përsëritur, që synojnë, shkaktojnë ose kanë të ngjarë të shkaktojnë dëm fizik, psikologjik, seksual ose ekonomik, përfshirë, por pa u kufizuar në dhunën digjitale në internet, rrjete sociale, *email*-e, e mesazhe të tjera elektronike, përfshin edhe dhunën dhe ngacmimin me bazë gjinore;

d) "Dhunë dhe ngacmim/shqetësim me bazë gjinore" është dhuna dhe ngacmimi/shqetësimi ndaj personave për shkak të seksit ose gjinisë së tyre ose që prekin në mënyrë disproporcionale personat e një seksi ose gjinie të veçantë, përfshin dhe ngacmimin seksual;

dh) "Gra dhe burra" në kuptim të këtij ligji nënkupton edhe të reja dhe të rinj, si dhe vajza dhe djem;

e) "Gjuhë me ndjeshmëri gjinore" është gjuha e përdorur dhe e zhvilluar, e folur dhe e shkruar, që shmang stereotipat gjinorë, i drejtohet cilësdo gjini dhe i vlerëson ato në mënyrë të njëjtë;

ë) "Gjini" nënkupton rolet e ndërtuara në kontekstin social, sjelljet, aktivitetet dhe atributet që

një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për gratë dhe burrat;

f) "Integrim gjinor" është procesi i vlerësimit të pasojave që sjell, për shkak të gjinisë, çdo veprim i planifikuar, përfshirë legjislacionin, politikat, programet dhe buxhetet, organizimi dhe/ose riorganizimi, përmirësimi, hartimi dhe zbatimi i proceseve politikëbërëse, programore, buxhetore apo ligjore, në të gjitha fushat dhe nivelet;

g) "Masa për sigurimin e barazisë gjinore" janë masat e përgjithshme, të veçanta ose të përkohshme, dhe përfshijnë masa ligjore e politike, aktivitete, kritere, praktika e vendime dhe çdo veprim tjetër të nevojshëm e të arsyeshëm në kontekstin e masave që synojnë përshpejtimin e vendosjes së barazisë gjinore. Këto masa nuk përbëjnë diskriminim dhe ndërpriten me arritjen e objektivave të barazisë gjinore për të cilët janë vendosur;

gj) "Ngacmim ose shqetësim seksual" është çdo formë e padëshiruar sjelljeje, e shprehur me gjeste, veprime, fjalë, të thëna ose të shkruara, përfshirë edhe ato elektronike, praktika ose sjellje, veprime fizike dhe simbolike, me natyrë seksuale, që ka për qëllim ose sjell si pasojë cenimin e dinjitetit personal, në mënyrë të veçantë kur krijon një mjedis kërcënues, armiqësor, poshtërues, nënshtrues, përçmues apo fyes;

h)"Përfaqësim i barabartë gjinor" është përfaqësimi i secilës prej gjinive në të gjithë diversitetin e tyre, në mënyrë të barabartë dhe asnjëherë me jo më pak se 30 deri në 50 për qind, sipas përcaktimit në këtë ligj, në terma të aksesit dhe fuqisë së barabartë në të gjitha sistemet e vendimmarrjes (vendimmarrje që zhvillohet përmes proceseve formale dhe joformale në të gjithë sektorët, duke përfshirë, por pa u kufizuar në atë politik, publik, ekonomik dhe hapësirën digjitale);

i) "Përkatësi gjinore" janë rolet, mundësitë, sjelljet, aktivitetet dhe atributet shoqërore, të cilat lidhen me seksin e lindur dhe që shoqëria i stereotipizon si të përshtatshme për gratë dhe burrat, duke përfshirë marrëdhëniet e ndërsjella midis tyre, si edhe midis vetë grave dhe midis vetë burrave;

j) "Punë me vlerë të barabartë" është puna që vlerësohet mbi të njëjtat kritere pa diskriminim për shkak të gjinisë;

k) "Përkatësi e shumëfishtë" është ndërlidhja/ kombinimi i gjinisë me karakteristika të ndryshme të parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi;

l) "Punë e papaguar" është puna që prodhon mallra dhe shërbime, por që nuk ka shpërblim të drejtpërdrejtë ose formë tjetër pagese;

ll) "Seksizëm" është çdo akt, veprim, gjest, përfaqësim vizual, fjalë të shkruara ose të thëna në median audiovizive, elektronike dhe/ose atë të shkruar, praktika ose sjellje të bazuara në idenë se një person ose grup personash është inferior për shkak të gjinisë, që ndodh në sferën publike ose private, *online*, me efekt dhe qëllim dhunimin e dinjitetit të njeriut, të të drejtave dhe lirive themelore të një personi apo grupi personash, shtetaseje/shtetasi shqiptar/e, i/e huaj apo pa shtetësi, që rezulton në dëm ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose socio-ekonomike ndaj një personi apo grupi personash, shtetaseje/shtetasi shqiptar/e, i/e huaj apo pa shtetësi ose që krijon apo ushqen krijimin e një mjedisi që ngjall frikë, armiqësor, degradues, fyes ose poshtërues ose ushqen apo synon ruajtjen dhe përforcimin e stereotipave gjinorë;

m) "Të dhëna gjinore" janë të dhënat administrative dhe statistikore, të ndara sipas gjinisë, që pasqyrojnë ndryshimet dhe pabarazitë gjinore mes gjinive në të gjitha fushat e jetës, të mbledhura, të përpunuara dhe të publikuara, me qëllim hartimin dhe monitorimin e politikave që synojnë arritjen e barazisë gjinore;

n) "Tregues gjinor", mjetet për matjen e pabarazive gjinore ose të çështjeve specifike gjinore, i cili përdoret për të matur progresin e arritur drejt angazhimeve të ndryshme përmes strategjive dhe politikave vendase e ndërkombëtare, të ndërmarra nga shteti shqiptar;

nj) "Vlerësimi i ndikimit gjinor" është vlerësimi që realizohet për projektligjet, përmes të cilit analizohet ndikimi i politikave në uljen, ruajtjen ose rritjen e pabarazisë gjinore ose vlerësimi se si ligjet ekzistuese kanë ndikuar në uljen, ruajtjen ose rritjen e pabarazisë gjinore;

o) "Diskriminim ndërsektorial" është formë diskriminimi në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyrë të atillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta të diskriminimit;

p) "Stereotipat gjinorë" janë ide të paracaktuara, sipas të cilave grave dhe burrave u caktohen në mënyrë arbitrare cilësi dhe role të përcaktuara vetëm

nga gjinia e tyre, të cilat kufizojnë mundësitë e zhvillimit të tyre në jetën publike dhe private.

2. Termat e tjerë të përdorur në këtë ligj, të papërkufizuar në pikën 1 të këtij neni dhe që përkufizohen në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi, kanë të njëjtin kuptim si në atë legjislacion.

Neni 5
Subjektet e mbrojtura

1. Ky ligj mbron nga diskriminimi gjinor dhe nga pabarazitë gjinore për shkak të përkatësisë së shumëfishtë të gjithë personat që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Shtetaset/shtetasit shqiptarë me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë gëzojnë mbrojtjen që ofron ky ligj në marrëdhëniet me subjektet publike dhe private, që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Personat fizikë e juridikë të huaj me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë gëzojnë mbrojtjen që ofron ky ligj në marrëdhëniet me subjektet publike dhe private, që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 6
Ndalimi i diskriminimit për shkak të gjinisë

1. Çdo trajtim më pak i favorshëm i një personi për shkak të gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, shprehjes së identitetit gjinor ose karakteristikave të seksit, në krahasim me trajtimin që i bëhet, i është bërë ose do t'i bëhej një personi të gjinisë tjetër në një situatë të njëjtë ose të ngjashme, përbën diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të gjinisë dhe ndalohet. Ky ndalim përfshin edhe diskriminimin ndërsektorial dhe të gjitha format e tjera të diskriminimit.

2. Hartimi, zbatimi, nxitja dhe krijimi i dispozitave, kushteve, kritereve apo praktikave, në dukje neutrale, por që sjellin vendosjen në një situatë më pak të favorshme të një personi të njërës gjini, krahasuar me personat e gjinisë tjetër, përbën diskriminim të tërthortë për shkak të gjinisë dhe ndalohet. Në vlerësimin e këtij diskriminimi merren parasysh rezultati, pabarazitë historike dhe sistematike, që prekin në mënyrë jopërpjesëtimore gjinitë e ndryshme.

3. Nga ky ndalim bëjnë përjashtim rastet kur këto dispozita, kushte, kritere apo praktika justifikohen nga një qëllim i përligjur, i arsyeshëm dhe objektiv, dhe mjetet apo rrugët për arritjen e këtij qëllimi janë të nevojshme dhe të përshtatshme.

4. Subjektet publike dhe private janë të detyruara të marrin në shqyrtim çdo kërkesë apo ankim, të kryejnë çfarëdo procedurë për shqyrtimin e pretendimeve për diskriminim, si dhe çdo formë tjetër sjellje që cenon parimet e barazisë gjinore, të parashikuara në këtë ligj.

KREU II
MASAT PËR SIGURIMIN E BARAZISË GJINORE

Neni 7
Masat e përgjithshme për sigurimin e barazisë gjinore

1. Për arritjen e barazisë gjinore dhe eliminimin e diskriminimit për shkak të gjinisë apo pabarazive gjinore për shkak të përkatësisë së shumëfishtë, subjektet publike marrin masa të përgjithshme sipas kompetencave të tyre:

a) sigurojnë përmes masave legjislative ose me mjete të tjera të përshtatshme zbatimin praktik të parimit të barazisë gjinore dhe marrjen parasysh të interesave, nevojave dhe prioriteteve të ndryshme gjinore gjatë planifikimit, përgatitjes, hartimit, miratimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave, ligjeve, buxheteve, programeve, marrjes dhe zbatimit të vendimeve;

b) sigurojnë përmes masave legjislative ose me mjete të tjera të përshtatshme zbatimin praktik të parimit të barazisë gjinore përmes integrimit gjinor, buxhetimit të përgjigjshëm gjinor dhe sigurimit të burimeve njerëzore të kualifikuara;

c) sigurojnë përmes rregullimeve ligjore dhe nënligjore ose me mjete të tjera të përshtatshme ndryshimin ose shfuqizimin e çdo akti ligjor, zakoni apo praktike, që përbën diskriminim për shkak të gjinisë;

ç) përgatisin, sipas rastit, analiza gjinore për integrimin gjinor dhe për politikat transformative dhe të përgjigjshmërisë gjinore, si dhe analiza të ndikimit gjinor;

d) marrin masa për përfshirjen e këndvështrimit gjinor në përgatitjen, hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e akteve ligjore,

politikave, strategjive, buxheteve, programeve të shpenzimeve, aktiviteteve të projekteve, masave rregullatore, funksioneve administrative dhe kulturës institucionale, me synim nxitjen e barazisë ndërmjet grave dhe burrave, si dhe parandalimin e eliminimin e diskriminimit;

dh) marrin të gjitha masat e përshtatshme për të krijuar lehtësitë e nevojshme e të përligjura objektivisht për arritjen e barazisë gjinore faktike dhe për mundësi e akses të barabartë gjinor;

e) sigurojnë mbrojtje efektive ndaj çdo veprimi diskriminues sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

2. Masat e përgjithshme përcaktohen sipas nevojës dhe marrin në konsideratë rekomandimet dhe gjetjet e përcaktuara në raportet vjetore dhe rezolutat e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, raportet ndërkombëtare për Republikën e Shqipërisë, Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore apo akte të tjera që adresojnë çështjet gjinore; raportet vjetore që paraqiten në Kuvend nga ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore në bashkëveprim edhe me institucionet e tjera përgjegjëse.

3. Sipas rastit dhe fushës së veprimtarisë së tyre, organizatat e shoqërisë civile nxisin marrjen e masave të përgjithshme.

Neni 8
Masat e përkohshme

1. Masat e përkohshme përfshijnë kuotat për të arritur përfaqësim të barabartë gjinor e gjithëpërfshirës në çdo fushë, ku personat e njërës gjini nuk gëzojnë pozitë të barabartë me personat e gjinisë tjetër apo me personat brenda së njëjtës gjini.

2. Masat e përkohshme merren edhe në ato raste kur personat e njërës gjini nuk gëzojnë pozitë të barabartë gjinore me personat e gjinisë tjetër apo me personat brenda së njëjtës gjini, për shkak të gjendjes familjare apo shëndetësore apo një gjendjeje të veçantë, që nuk varet prej tyre.

3. Subjektet publike dhe private vlerësojnë periodikisht situatën dhe, në varësi të saj, propozojnë marrjen e masave të përkohshme, pezullimin ose shfuqizimin e masave të përkohshme, ose marrin masa të përkohshme që lidhen me aspekte të organizimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Neni 9
Masat e veçanta

1. Nuk përbëjnë diskriminim për shkak të gjinisë rastet kur subjektet publike dhe private marrin masa të veçanta, në përputhje me legjislacionin në fuqi që synojnë:

a) mbrojtjen e posaçme të grave gjatë shtatzënisë, lindjes dhe paslindjes, mbrojtjen e nënave të reja, si dhe të prindërve të rinj, për shkak të lindjes natyrore ose të birësimit të fëmijës apo të dhënies apo marrjes së fëmijës në kujdestari, duke krijuar kushte për mbrojtjen dhe lehtësimin e tyre në punë, sigurimet shoqërore e ndihmat sociale, sigurimin e ndihmës së nevojshme shëndetësore për nënën dhe fëmijën, sigurimin dhe nxitjen e sistemit të shërbimeve sociale, duke favorizuar zhvillimin e rrjetit të çerdheve e kopshteve;

b) lehtësimin e ndihmën për personat, që kanë përgjegjësi të veçanta në familje, për shkak të përkujdesjes së përditshme ndaj anëtarëve/ anëtarëve me aftësi të kufizuara në familje, për shkak të aftësive të kufizuara për shkak të moshës ose për çfarëdo shkaku tjetër paaftësie;

c) kufizimin për të punuar në disa sektorë të punëve të rënda dhe të rrezikshme për gratë shtatzëna dhe ato me fëmijë në gji. Këto kufizime do të rishikohen periodikisht, në varësi të njohurive shkencore e teknike dhe sipas nevojave që paraqiten;

ç) rritjen e aksesit të grave në të gjithë diversitetin e tyre në programet sociale të strehimit, sipas legjislacionit përkatës, me një vëmendje të veçantë te viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit, vajzat nëna, familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, gratë emigrante të kthyera, që bëjnë pjesë në një nga këto kategori, gratë e liruara nga burgu.

2. Në përcaktimin e masave të veçanta mbahen në vëmendje interesat, nevojat dhe prioritetet e ndryshme gjinore, me qëllim që të sigurohet:

a) e drejta për informacion dhe akses të barabartë në politika, programe dhe shërbime;

b) zbatimi i masave të integrimit gjinor dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në procesin dhe fazat e planifikimit, raportimit, menaxhimit dhe zbatimit të planeve, projekteve dhe politikave;

c) promovimi i mundësive të barabarta në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe në tregun e punës;

ç) përfaqësimi i barabartë gjinor dhe gjithëpërfshirës në pozicionet administrative dhe mbikëqyrëse;

d) përfaqësimi i balancuar gjinor në çdo fazë të formulimit dhe zbatimit të politikave të barazisë gjinore;

dh)mbledhja e të dhënave përkatëse, të ndara sipas seksit dhe statistikave gjinore.

Neni 10
Gjuha e ndjeshme gjinore gjithëpërfshirëse

1. Institucionet legjislative, ekzekutive, gjyqësore dhe subjektet private marrin masa që në hartimin, miratimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave, legjislacionit, programeve, buxheteve dhe çdo informacioni të përdorin një gjuhë me ndjeshmëri gjinore, gjithëpërfshirëse dhe me aksesueshmëri, me qëllim heqjen e stereotipave gjinorë në modelet sociale, kulturore, zakonet dhe praktikat e bazuara në to, eliminimin e diskriminimit gjinor dhe pabarazive gjinore për shkak të përkatësisë së shumëfishtë, si dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e barazisë gjinore.

2. Ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive, si dhe të shtypit të shkruar, përfshirë edhe ato *online*, marrin masa për përdorimin e gjuhës me ndjeshmëri gjinore në programacionin e mediave të shkruara, elektronike, raportimin mediatik, si dhe çdo formë komunikimi me publikun.

3. Në certifikatat, diplomat, titujt akademikë, dokumentet e certifikimit të kualifikimeve profesionale, pozicionet e punës dhe profesionet, licencat, tekstet mësimore, materialet studimore, përkthimet, punimet e referimet shkencore, si botime të çdo lloji, përdoret gjuha në përputhje me gjininë gramatikore, si dhe gjithëpërfshirëse e me aksesueshmëri.

4. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përcaktojë me vendim rregullat e përdorimit të gjuhës me ndjeshmëri gjinore.

Neni 11
Vlerësimi i ndikimit gjinor

1. Çdo projektligj shoqërohet me vlerësimin e ndikimit gjinor, i cili synon që aktet të kenë parashikimet e duhura për të siguruar që gratë dhe burrat ndikohen nga to pa diskriminim gjinor, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

2. Përmbajtja, procedura dhe formulari tip i vlerësimit të ndikimit gjinor përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12
Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor

1. Institucionet publike sigurojnë zbatimin e politikave të barazisë gjinore, duke përfshirë interesat, nevojat dhe prioritetet e ndryshme të grave dhe burrave në të gjithë diversitetin e tyre, nëpërmjet zbatimit të integrimit gjinor dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në procesin e planifikimit, menaxhimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të politikave buxhetore, si dhe programeve, planeve dhe projekteve të zbatimit të tyre, me qëllim shpërndarjen mbi baza të nevojave specifike gjinore të burimeve.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore zbatojnë buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në procesin e planifikimit, menaxhimit dhe zbatimit të politikave, programeve, projekteve dhe planeve në fushat e tyre të veprimtarisë dhe rekomandimet e proceseve të monitorimit.

3. Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor synon vendosjen e barazisë gjinore të plotë, faktike dhe efektive nëpërmjet:

a) përfshirjes së një perspektive gjinore në të gjitha fazat e procesit buxhetor;

b) analizës së ndikimeve që politikat fiskale dhe buxhetore kanë mbi gratë dhe burrat në të gjithë diversitetin e tyre dhe përdorimit të këtyre analizave për të informuar planifikimin e përmirësuar të buxhetit dhe politikave përkatëse të zbatimit të tij;

c) kontributit që ofron në alokimin, shpenzimin dhe monitorimin me transparencë, eficiencë dhe efektivitet të fondeve buxhetore.

Neni 13
Të dhënat gjinore

1. Instituti i Statistikave harton dhe publikon të dhëna gjinore dhe indeksin e barazisë gjinore në përputhje me kriteret e cilësisë statistikore, sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare për statistikat dhe që konsiderojnë nevojat, interesat dhe prioritetet sipas gjinive.

2. Instituti i Statistikave, në bashkëpunim me subjektet publike dhe private, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, mbledh, përpunon, zhvillon dhe

shpërndan të dhëna gjinore në çdo fushë statistikore, përfshirë punësimin, edukimin, bujqësinë dhe zhvillimin rural, arsimin, shkencën dhe kërkimin shkencor, formimin profesional, teknologjinë e informacionit dhe komunikimin dhe shoqërinë e informacionit, informimin publik dhe median, sportin e veprimtarinë sportive, mbrojtjen sociale dhe shëndetësinë, mbrojtjen e sigurinë, transportin, infrastrukturën dhe planifikimin urban, mjedisin, emergjencat civile dhe menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë, kulturën, si dhe në procesin vendimmarrës.

3. Ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore, në bashkëpunim me grupin ndërinstitucional për statistikat gjinore, propozon mekanizmat e mbledhjes, përpunimit dhe raportimit të të dhënave, të ndara sipas seksit, statistikave gjinore dhe treguesve gjinorë, si dhe bashkëdrejton grupin ndërinstitucional për statistikat gjinore.

4. Në përputhje me legjislacionin për statistikat zyrtare, Instituti i Statistikave merr masa për pasqyrimin e planit të aktiviteteve statistikore për barazinë gjinore në Programin e Statistikave Zyrtare dhe planin vjetor për zbatimin e tij. Raporti vjetor për Sistemin Kombëtar Statistikor, i cili i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë, duhet të përmbajë një seksion të veçantë për statistikat e barazisë gjinore dhe aktivitetet e kryera për prodhimin e tyre.

5. Organizimi dhe funksionimi i grupit ndërinstitucional për statistikat gjinore miratohen me urdhër të Kryeministrit.

KREU III
AUTORITETET PËRGJEGJËSE PËR ARRITJEN E BARAZISË GJINORE

Neni 14
Autoritetet përgjegjëse për përmirësimin dhe arritjen e barazisë gjinore

1. Autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore.

2. Pa u kufizuar në sa vijon, autoritetet e tjera përgjegjëse përfshijnë:

a) Kuvendin e Shqipërisë;

b) Këshillin e Ministrave;

c) Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore;

ç) Komisioneren/Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi;

d) Avokatin e Popullit;

dh) të gjitha ministritë dhe institucionet e tjetra të administratës publike sipas fushës së përgjegjësisë dhe kompetencave të tyre;

e) njësitë e vetëqeverisjes vendore;

ë) organizatat jofitimprurëse, të cilat ushtrojnë veprimtari në fushën e barazisë gjinore;

f) median dhe çdo subjekt privat.

Neni 15
Kuvendi

1. Kuvendi merr në shqyrtim raportin vjetor për gjendjen e barazisë gjinore në vend, të paraqitur nga Këshilli i Ministrave, dhe miraton rezolutën përkatëse.

2. Kuvendi, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore, harton periodikisht, jo më pak se një herë në 4 vjet, në përfundim të një legjislature, kontrollin postlegjislativ të zbatimit të këtij ligji. Kuvendi konsultohet me organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit për hartimin e raportit për kontrollin postlegjislativ të zbatimit të ligjit për barazinë gjinore.

3. Raporti për kontrollin postlegjislativ të zbatimit të ligjit për barazinë gjinore publikohet në faqen e Kuvendit, si dhe të ministrisë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore.

Neni 16
Roli i institucioneve të pavarura

Institucionet e pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj ushtrojnë rol proaktiv gjatë zbatimit të kuadrit ligjor dhe politikave publike për barazinë gjinore në respektim të këtij ligji, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e tyre të përcaktuara në Kushtetutë dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 17
Këshilli i Ministrave

Këshilli i Ministrave ushtron këto kompetenca në fushën e barazisë gjinore:

a) merr masa për pajtueshmërinë dhe harmonizimin e politikave në fushën e barazisë gjinore me detyrimet e *acquis* të Bashkimit Evropian për barazinë gjinore dhe ato ndërkombëtare në tërësi;

b) rishikon aktet në fuqi për funksionimin e Këshillit të Ministrave, me qëllim përfshirjen e vlerësimit të ndikimit gjinor në aktet ligjore, si dhe kujdeset që aktet ligjore të shoqërohen me vlerësimin e ndikimit gjinor, sipas parashikimeve të këtij ligji;

c) merr masa për pjesëmarrjen e barabartë dhe gjithëpërfshirëse të grave dhe burrave në të gjithë diversitetin e tyre në zhvillimin dhe zbatimin e politikave, përfshirë edhe ato për barazinë gjinore;

ç) garanton integrimin gjinor në çdo politikë që zhvillon dhe zbaton;

d) përcakton masa me qëllim arritjen faktike të barazisë gjinore për ushtrimin e të drejtave dhe lirive të grave dhe burrave në të gjithë diversitetin e tyre, si dhe parandalimin dhe eliminimin e diskriminimit gjinor dhe pabarazive gjinore për shkak të përkatësisë së shumëfishtë;

dh) miraton strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit për arritjen e barazisë gjinore në shoqëri dhe planin e veprimit për zbatimin e agjendës "Gruaja, paqja dhe siguria" dhe planeve të tjera të nevojshme;

e) shqyrton në një nga mbledhjet e tij raportin e përvitshëm për situatën në lidhje me barazinë gjinore, të hartuar sipas këtij ligji nga ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore, para paraqitjes së tij në Kuvend;

ë) ushtron çdo kompetencë tjetër në lidhje me barazinë gjinore sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 18

Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore

1. Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore është organ këshillimor, që ngrihet me urdhër të Kryeministres/Kryeministrit, me propozim të ministres/ministrit që mbulon çështjet e barazisë gjinore. Përbërja e tij miratohet mbi bazën e përfaqësimit të barabartë gjinor e gjithëpërfshirës.

2. Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore kryesohet nga ministrja/ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore dhe ka në përbërje:

a) zëvendësministren/zëvendësministrin e ministrisë që mbulon çështjet e barazisë gjinore;

b) një përfaqësuese/përfaqësues nga secila ministri në nivel zëvendësministreje/ zëvendësministri;

c) Avokatin e Popullit;

ç) Komisioneren/Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi;

d) një përfaqësuese/përfaqësues nga INSTAT-i;

dh) një përfaqësuese/përfaqësues nga Autoriteti i Mediave Audiovizive;

e) një përfaqësuese/përfaqësues nga institucioni i ngarkuar me sistemin e integruar të politikave në vend;

ë) pesë përfaqësuese/përfaqësues me përvojë nga organizatat jofitimprurëse, të zgjedhur nga vetë ato, që kanë si qëllim të veprimtarisë së tyre fushën e barazisë gjinore.

3. Sipas rastit, ministrja/ministri përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore fton të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore eksperte/ekspertë të veçantë nga organizatat e tjera të shoqërisë civile, fushës akademike dhe/ose eksperte/ekspertë të fushës ose përfaqësuese/ përfaqësues nga institucione të ndryshme të qeverisjes qendrore apo vendore, si dhe shoqatave të njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe të organizatave ndërkombëtare, pa të drejtë vote.

4. Për çështje të një rëndësie të veçantë për të këshilluar politikat gjinore, Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore mund të zhvillojë mbledhje të përbashkëta me çdo organ tjetër kolegjial sipas nevojës.

5. Mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore janë publike. Publiciteti i mbledhjes sigurohet përmes publikimit të agjendës së mbledhjes paraprakisht, mundësisë së ndjekjes *online* të mbledhjeve nga subjektet e interesuara dhe publikimit të akteve të miratuara.

6. Mandati i anëtareve/anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore është 4 vjet, me të drejtë riemërimi, me përjashtim të anëtareve/ anëtarëve që janë zgjedhur për shkak të detyrës. Në çdo rast, ripërtëritja e të gjithë anëtareve/anëtarëve të Këshillit në të njëjtën kohë ndalohet. Ministrja/ ministri përgjegjës për barazinë gjinore kujdeset që përbërja e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore të pasqyrojë balancën e kërkuar gjinore e gjithëpërfshirëse sipas këtij ligji. Drejtoria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore në ministrinë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore luan rolin e sekretariatit të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore.

7. Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 19
Detyrat e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore

1. Detyrat e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore janë si më poshtë vijon:

a) këshillon Këshillin e Ministrave për përcaktimin e drejtimit të politikave shtetërore për barazi gjinore;

b) i këshillon çdo autoriteti përgjegjës për barazinë gjinore masa për integrimin gjinor në të gjitha fushat;

c) i propozon Këshillit të Ministrave programet kryesore për nxitjen dhe arritjen e barazisë gjinore;

ç) vlerëson gjendjen konkrete të barazisë gjinore dhe dhunës me bazë gjinore në vend, bazuar në të dhëna të përditësuara, si dhe i rekomandon, sipas rastit, Këshillit të Ministrave, ministrisë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe çdo autoriteti tjetër përgjegjës marrjen e masave me qëllim përmirësimin e gjendjes;

d) vlerëson efektivitetin e strukturës përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore në ministrinë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe rekomandon përmirësimet e nevojshme strukturore;

dh) shqyrton raportin vjetor për çështjet e barazisë gjinore të hartuar nga ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore, përpara shqyrtimit dhe miratimit të tij nga Këshilli i Ministrave;

e) bashkëpunon në vijimësi me organizatat jofitimprurëse dhe merr mendimin e tyre për çështje të barazisë gjinore, si dhe dhunës me bazë gjinore;

ë) vlerëson gjendjen e zbatimit të detyrimeve të Republikës së Shqipërisë në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare që lidhen me barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore, dhe, sipas rastit, u rekomandon autoriteteve përgjegjëse marrjen e masave të nevojshme në përputhje me këto detyrime.

2. Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore shqyrton të paktën në një nga mbledhjet e veta vjetore masat e marra për zbatimin e detyrave të ministrive sipas kreut VI të këtij ligji.

Neni 20
Detyrat e autoritetit kryesor përgjegjës

1. Ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore, si autoriteti kryesor përgjegjës, ka këto detyra:

a) harton politikat për barazinë gjinore, koordinon, zbaton dhe mbikëqyr zbatimin e këtij ligji, strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit për arritjen e barazisë gjinore, si dhe të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e barazisë gjinore;

b) jep mendim për projektaktet e Këshillit të Ministrave lidhur me respektimin e standardeve të barazisë gjinore;

c) i propozon Këshillit të Ministrave ndryshime ligjore e nënligjore, nënshkrimin e akteve ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore dhe të të drejtave të grave, si dhe ndërmarrjen e masave të tjera që synojnë të zhdukin dallimet ndërmjet gjinive në gëzimin e të drejtave dhe ofrimin e mundësive, pasi këshillohet me Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore;

ç) bashkëpunon me të gjitha ministritë sipas fushave të tyre të përgjegjësisë, me qëllim identifikimin, hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave, programeve dhe/ose projekteve për arritjen e barazisë gjinore në fushat e tyre;

d) bashkëpunon dhe u ofron mbështetje organizatave jofitimprurëse aktive në fushën e barazisë gjinore;

dh) ndërmerr fushata ndërgjegjësimi për çështjet e barazisë gjinore sipas parashikimeve të këtij ligji, përfshirë reduktimin e punës së papaguar dhe vendosjen e ekuilibrit mes punës dhe përgjegjësive familjare, në bashkëpunim me sindikatat dhe organizatat e tjera përfaqësuese të punëmarrëseve/punëmarrësve, organizatat përfaqësuese të punëdhënëseve/punëdhënësve dhe organizatat jofitimprurëse aktive në fushën e barazisë gjinore, me qëllim arritjen e barazisë gjinore;

e) paraqet pranë institucioneve të trajnimit dhe formimit profesional nevojat për trajnim dhe formim profesional të nëpunëseve/nëpunësve të barazisë gjinore dhe të punonjëseve/punonjësve të administratës publike për të rritur kuptimin e tyre mbi çështjet e barazisë gjinore;

ë) propozon mekanizmat e mbledhjes së të dhënave të ndara sipas seksit, statistikave gjinore dhe treguesve gjinorë, në bashkëpunim me Institutin e

Statistikave dhe me institucionet e tjera shtetërore; kërkon informacion për metodologjinë e mbledhjes dhe përpunimit të tyre, si dhe drejton grupin ndërinstitucional për statistikat gjinore;

f) vetë ose në bashkëpunim me institucione të tjera, realizon kërkime dhe studime për çështje të barazisë gjinore, me qëllim sigurimin e të dhënave të përditësuara dhe periodike për situatën e barazisë gjinore në vend për të informuar vendimmarrjet politike;

g) organizon grumbullimin, analizën dhe përhapjen e informacionit për situatën e barazisë gjinore dhe kërkon të paktën një herë në vit nga ministritë përgjegjëse, të përcaktuara në pjesën V të këtij ligji, të dhëna konkrete në lidhje me zbatimin e kompetencave të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj;

gj) brenda tremujorit të parë të çdo viti, i paraqet Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore raportin e vitit paraardhës për veprimtarinë e realizuar, ecurinë e punës për arritjen e barazisë gjinore, problemet e hasura dhe rrugët për kapërcimin e tyre;

h) organizon mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore. Drejtoria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore në këtë ministri, në rolin e sekretariatit të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore, përgatit materialet, aktet dhe dokumentet e nevojshme që paraprijnë ose pasojnë këto mbledhje;

i) raporton pranë strukturave përgjegjëse për arritjet e vendit në kuadër të angazhimeve të vendit për objektiva në nivel ndërkombëtar.

2. Subjektet publike në nivel qendror e vendor dhe subjektet private kanë detyrimin ligjor për të bashkëpunuar me ministrinë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore për shkëmbimin e informacionit dhe lehtësimin e përmbushjes së funksioneve në kuadër të këtij ligji.

3. Me qëllim realizimin e detyrave në kuadër të këtij ligji, në ministrinë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore krijohet një strukturë e posaçme për çështjet gjinore të paktën në nivel drejtorie.

Neni 21

Ministritë dhe institucionet e tjera të administratës publike

Ministritë dhe institucionet e tjetra të administratës publike:

a) bashkëpunojnë me ministrinë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore për hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e legjislacionit, politikave, buxheteve e projekteve për barazinë gjinore në fushat e përgjegjësisë së tyre;

b) bashkëpunojnë me organizatat jofitimprurëse për arritjen e barazisë gjinore në fushat e përgjegjësisë së tyre;

c) publikojnë të dhëna në lidhje me çështjet e barazisë gjinore në institucionet e tyre, në përputhje me të dhënat e ndara sipas seksit, statistikave gjinore dhe treguesve gjinorë të kërkuar edhe në bazë të këtij ligji;

ç) ushtrojnë kompetencat e përcaktuara në këtë ligj apo kuadrin ligjor në tërësi për barazinë gjinore.

Neni 22

Njësitë e vetëqeverisjes vendore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë detyrat si më poshtë:

a) bashkëpunojnë me qeverisjen qendrore për zbatimin e legjislacionit dhe politikave shtetërore për barazinë gjinore;

b) bashkëpunojnë ngushtë me organizatat jofitimprurëse për arritjen e barazisë gjinore në fusha të ndryshme në territorin që mbulojnë;

c) kryejnë mbledhjen e rregullt periodike, përpunimin dhe raportimin e të dhënave sipas një metodologjie të unifikuar, të ndara sipas treguesve gjinorë të ndërlidhur me tregues të tjerë socialë dhe demografikë;

ç)publikojnë në faqet e tyre të internetit të dhëna në lidhje me çështjet e barazisë gjinore në njësitë e tyre;

d) hartojnë dhe zbatojnë plane vendore veprimi në fushën e barazisë gjinore përmes proceseve pjesëmarrëse, konsultuese e gjithëpërfshirëse gjinore me grupet e interesit, duke u bazuar në legjislacionin dhe politikat në fuqi, si dhe në mjete të përshtatshme për njësitë e vetëqeverisjes vendore në nivel evropian, përfshirë, por pa u kufizuar në Kartën Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore.

2. Çdo person juridik i krijuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore respekton parimin e përfaqësimit të barabartë gjinor e gjithëpërfshirës, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 23
Nëpunësja/nëpunësi i barazisë gjinore

1. Në administratën e Kuvendit, në institucionet publike qendrore, si dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore me të paktën 200 000 banorë caktohet të paktën një punonjëse/punonjës në pozicionin e nëpunëses/nëpunësit të barazisë gjinore.

2. Nëpunësja/nëpunësi i barazisë gjinore ka kualifikime në fushën e barazisë gjinore, si dhe kontribuon në përfshirjen e aspektit gjinor në politikat, strategjitë, planet, programet, buxhetet dhe projektet e institucionit për fushat në të cilat institucioni është përgjegjës.

3. Nëpunësja/nëpunësi i barazisë gjinore ushtron detyrat, si më poshtë:

a) nxit, kontribuon, mbështet dhe monitoron integrimin e barazisë gjinore në politikat, planet, programet, buxhetet dhe projektet e institucionit, duke konsideruar përshtatjen e tyre ndaj nevojave dhe realiteteve të posaçme të institucionit përkatës;

b) mbledh dhe analizon në bashkëpunim me njësitë përkatëse në institucion të dhëna të ndara sipas seksit dhe statistikave gjinore;

c) është pjesë e grupeve të punës që ngrihen për realizimin e analizave dhe/ose studimeve gjinore për të informuar politikëbërjen qendrore dhe vendore;

ç) është anëtar/e grupeve të punës dhe komisioneve që ngrihen në nivel të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve publike për hartimin e strategjive, politikave, planeve vendore të veprimit, si dhe për shqyrtimin, vlerësimin dhe vendosjen e kritereve të ndjeshme gjinore e gjithëpërfshirëse në të gjitha masat dhe veprimet që ndërmerr e zbaton institucioni;

d) nxit zhvillimin e partneriteteve për çështjet e barazisë gjinore në fushën e veprimtarisë së institucionit;

dh) çdo detyrë tjetër të caktuar në përshkrimin e punës, me qëllim zbatimin e këtij ligji.

4. Nëpunësja/nëpunësi i barazisë gjinore bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe i siguron të dhëna, informacione dhe ndihmë të nevojshme në zbatim të këtij ligji sipas kërkesave të kësaj ministrie.

KREU IV
PËRFAQËSIMI GJITHËPËRFSHIRËS DHE I BARABARTË GJINOR NË PROCESIN E VENDIMMARRJES

Neni 24
Përfaqësimi gjithëpërfshirës dhe i barabartë gjinor në sistemet e vendimmarrjes

1. Përfaqësimi gjithëpërfshirës dhe i barabartë gjinor në sistemet e vendimmarrjes arrihet nëse sigurohet barazia në masën 50 për qind, duke mos lejuar në asnjë rast përfaqësimin më pak se 30 për qind për secilën gjini, përmes transparencës dhe integritetit në proceset e emërimit dhe përzgjedhjes për pozicionet vendimmarrëse dhe në pozicionet drejtuese në nivel vendor, rajonal, qendror dhe ndërkombëtar.

2. Përfaqësimi gjithëpërfshirës dhe i barabartë gjinor në të gjitha organet vendimmarrëse të pushtetit legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor, institucionet e tjera publike, si dhe subjektet private arrihet nëse sigurohet:

a) përfaqësim në masën 50 për qind të secilës gjini dhe në asnjë rast jo më pak se 30 për qind e secilës gjini në të gjitha nivelet drejtuese dhe të barasvlershme me to në administratën publike qendrore e vendore, si dhe në sistemin e drejtësisë;

b) përfaqësim në masën 50 për qind të secilës gjini dhe në asnjë rast jo më pak se 30 për qind e secilës gjini në nivelet drejtuese të shërbimit diplomatik e konsullor të vendit;

c) përfaqësim në masën 50 për qind të secilës gjini dhe në asnjë rast jo më pak se 30 për qind e secilës gjini në organet përfaqësuese të qeverisjes vendore dhe Kuvendin e Republikës së Shqipërisë;

ç) pjesëmarrje dhe përfaqësim në masën 50 për qind të secilës gjini dhe në asnjë rast jo më pak se 30 për qind e secilës gjini në organet administruese të procesit të zgjedhjeve qendrore e vendore;

d) përfaqësim në masën 50 për qind të secilës gjini dhe në asnjë rast jo më pak se 30 për qind e secilës gjini në borde drejtuese, në këshillat mbikëqyrës dhe ato të administrimit të subjekteve private.

3. Për garantimin e masave të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, subjektet e këtij ligji ndërmarrin në mënyrë progresive masa për rritjen e kuotës së përfaqësimit të secilës gjini nga 30 deri në 50 për qind, gjatë një periudhe 10-vjeçare. Kjo kuotë

synon të arrihet duke integruar kriteret e gjithëpërfshirjes dhe diversitetit gjinor në të gjitha procedurat e konkurrimit dhe/ose emërimit. Për pozicionet që mbulohen nga nëpunës civilë, zbatimi i kësaj dispozite realizohet në përputhje me legjislacionin për shërbimin civil.

4. Përfaqësimi nën masën 30 për qind për secilën gjini në të gjitha sistemet e vendimmarrjes përbën diskriminim gjinor.

KREU V
MBROJTJA DHE TRAJTIMI I BARABARTË NË BAZË TË PËRKATËSISË GJINORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 25
Detyrimet e punëdhënëses/punëdhënësit në marrëdhëniet e punës

Punëdhënësja/punëdhënësi dhe çdo individ, që vepron në emër dhe për llogari të saj/tij, me cilësinë e ndërmjetëses/ndërmjetësit, të agjentes/agjentit apo të përfaqësueses/përfaqësuesit detyrohet që për promovimin e barazisë gjinore para dhe gjatë marrëdhënieve të punës, në përputhje edhe me parashikimet sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi:

a) të mos përfshijë elemente të diskriminimit në bazë të gjinisë apo të pabarazive gjinore për shkak të përkatësisë së shumëfishtë në shpalljen e vendit të lirë të punës dhe të sigurojë mundësi të barabarta për gratë dhe burrat, si dhe të rejat e të rinjtë në të gjithë diversitetin e tyre për të aplikuar në vendet e lira të punës;

b) kur për një vend të lirë pune ose për një kategori të caktuar pune ka një shpërndarje të pabarabartë të grave dhe burrave apo të rejave dhe të rinjve, nuk përbën diskriminim nëse shpallja vë në dukje qëllimin e vendosjes së parimeve të barazisë;

c) të zbatojë kritere të njëjta në të gjitha procedurat e rekrutimit, me përjashtim të rasteve të veçanta të përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji, apo në legjislacionin në fuqi. Punëdhënësja/punëdhënësi nuk mund të disfavorizojë një punëkërkuese/ punëkërkues, duke vendosur rregulla, kritere ose metoda procedurale, që në dukje janë neutrale, por që në praktikë janë më pak të favorshme për personat e gjinisë tjetër, përveçse për shkaqe objektive dhe të arsyeshme;

ç) të punësojë pa diferencim gjinor apo për shkak të përkatësisë së shumëfishtë në çdo pozicion ose vend të lirë në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale;

d) të promovojë shpërndarje të barabartë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave e të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, në lloje të ndryshme të vendeve të punës dhe brenda kategorive të ndryshme të punëmarrëseve/punëmarrësve përmes trajnimit dhe zhvillimit të aftësive profesionale e të masave të tjera të përkohshme;

dh) të krijojë kushte pune të barabarta, mundësi të barabarta për informacion, trajnim, ritrajnim e kualifikim, përfshi pjesëmarrje dhe përfaqësim gjithëpërfshirës e të barabartë gjinor në programet e aftësimit dhe formimit profesional, dhe trajtim të barabartë të punëmarrëseve/punëmarrësve gjatë marrëdhënieve të punës;

e) të zbatojë kritere të barabarta në vlerësimin e cilësisë së punës. Punëdhënësja/punëdhënësi nuk mund të zbatojë një kriter vlerësues, në dukje neutral, por që në praktikë është në disavantazh të personave të gjinisë tjetër;

ë) të japë pagesë të barabartë për punë me vlerë të barabartë;

f) të marrë masa për ndalimin e diskriminimit, ngacmimeve dhe shqetësimeve seksuale ndaj punëmarrëses/punëmarrësit, sipas nenit 18 të këtij ligji;

g) të mos vendosë në pozitë të disfavorshme ose të mos marrë masa disiplinore ndaj punëmarrëses/ punëmarrësit, e cila/i cili kundërshton ose ankohet për diskriminim, ngacmim ose shqetësim seksual, si edhe ndaj punëmarrëses/punëmarrësit që dëshmon për veprime diskriminuese, ngacmim ose shqetësim seksual, të kryera prej punëdhënëses/punëdhënësit ose punëmarrëseve/punëmarrësve të tjerë.

Neni 26
Veprimet diskriminuese të punëdhënëses/punëdhënësit

1. Veprimet e punëdhënëses/punëdhënësit në sektorin publik ose privat janë diskriminuese nëse për shkak të gjinisë apo përkatësisë së shumëfishtë:

a) përdor standarde ose/dhe procedura të diferencuara ndaj punëmarrëseve/punëmarrësve, përfshirë ato/ata me shtetësi të huaj apo pa shtetësi të punësuar në Shqipëri, për shkak të statusit të tyre migrator, për rekrutimin, trajnimin dhe ritrajnimin,

promovimin në detyrë, nxitjen profesionale, menaxhimin dhe shpërndarjen e punës, kohëzgjatjen dhe kushtet e provës dhe të punës, sigurimet shoqërore dhe përfitimet në rastet e daljes në pension, papunësisë, sëmundjes, invaliditetit, paaftësisë për punë, të drejtën e lejes dhe të lejes së paguar, mbrojtjen e shëndetit dhe të sigurisë në punë, pagesën për punë me vlerë të barabartë, pjesëmarrjen, anëtarësimin në organizatat sindikale dhe pjesëmarrjen në aktivitetet e tyre, përveçse për shkaqe objektive dhe të arsyeshme, të parashikuara në nenin 9 të këtij ligji apo në legjislacionin në fuqi për punën dhe të huajt;

b) krijon kushte pune të diferencuara për punëmarrëset/punëmarrësit e të njëjtit nivel;

c) merr masa disiplinore ndaj punëmarrëses/ punëmarrësit, ndryshon kushtet e punës, e transferon në një punë tjetër, shkurton vende pune, pushon nga puna ose përfundon kontratën e punës;

ç) vendos në pozitë të disfavorshme punëmarrësen/punëmarrësin për shkak të një ankese ndaj veprimeve të mësipërme të punëdhënëses/punëdhënësit.

2. Ndalohet diskriminimi në përzgjedhjen e një kandidateje/kandidati për punë, në marrëdhëniet e punës dhe përfundimin e marrëdhënieve të punës nga punëmarrësja/punëmarrësi për shkaqe të lidhura me mundësinë për shtatzënësi në të ardhmen, shtatzëninë e planifikuar, shtatzëninë, ndërprerjen e shtatzënisë dhe çdo rrethanë mjekësore që lidhet me shtatzëninë, mëmësinë, përgjegjësinë prindërore, gjendjen civile dhe/ose përgjegjësitë familjare. Nuk përbën diskriminim nëse vendi i punës është përcaktuar si punë e rëndë ose e rrezikshme për shëndetin e grave me fëmijë në gji dhe grave shtatzëna në bazë dhe në zbatim të Kodit të Punës.

3. Gjatë proceseve të riorganizimit dhe reformimit të vendeve të punës, punëdhënësja/ punëdhënësi respekton rregullat e përfaqësimit gjithëpërfshirës e të barabartë gjinor në përfundimin e marrëdhënieve të punës me përjashtim të rasteve kur legjislacioni i posaçëm që rregullon marrëdhënien e punës parashikon ndryshe.

Neni 27

Përgjegjësitë e punëdhënëses/ punëdhënësit për mbrojtjen e punëmarrëses /punëmarrësit nga dhuna, diskriminimi, ngacmimi dhe shqetësimi seksual

1. Çdo formë e dhunës, diskriminimit, ngacmimit apo shqetësimit seksual në vendin e punës nga punëdhënësja/punëdhënësi dhe/ose punëmarrësja /punëmarrësi është e ndaluar. Ngacmimet seksuale të padëshiruara, kërkesat për favore dhe sjelljet e tjera verbale ose fizike të natyrës seksuale përbëjnë ngacmim seksual kur pranimi i një sjelljeje të tillë bëhet haptazi ose në mënyrë të nënkuptuar si kusht për punësimin e individit. Pranimi ose refuzimi i një sjelljeje të tillë nga një individ përdoret si bazë për vendimet e punësimit që ndikojnë mbi këtë individ ose një sjellje e tillë ka për qëllim ose pasojë ndërhyrjen e paarsyeshme në performancën e punës së individit ose krijimin e një mjedisi pune frikësues, armiqësor ose ofendues.

2. Punëdhënësja/punëdhënësi për të mbrojtur punëmarrëset/punëmarrësit nga dhuna, diskriminimi, ngacmimi e, veçanërisht, nga shqetësimi seksual ka për detyrë:

a) të hartojë një rregullore për dhunën, diskriminimin, ngacmimin dhe shqetësimin seksual në vendin e punës, ku të përfshihen mekanizmat e brendshëm, procedura formale e joformale, si dhe masat parandaluese e disiplinore për këto raste;

b) që, nëse merr dijeni, në mënyrë të tërthortë ose me ankesë nga një punëmarrëse/punëmarrës, e cila/i cili pretendon se është diskriminuar, dhunuar, ngacmuar ose shqetësuar seksualisht nga një punëmarrëse/punëmarrës tjetër, përmes një procesi të rregullt ligjor dhe sipas rregullave të këtij ligji për barrën e provës, të marrë masat e duhura organizative për ndalimin e vazhdimit dhe parandalimin e diskriminimit, të ngacmimit ose shqetësimit seksual dhe të zbatojë sanksionet disiplinore;

c) të informojë të gjitha/gjithë punëmarrëset/ punëmarrësit për ndalimin e dhunës, diskriminimit, të ngacmimit dhe shqetësimit seksual në vendin e punës, përmes afishimit të parashikimeve ligjore dhe të rregullores/eve në mjediset publike të vendit të punës, si dhe të mundësojë kuptimin e plotë të tyre me mjetet e veta ose/dhe me ndihmën e subjekteve të specializuara;

ç) të planifikojë dhe të garantojë pjesëmarrjen e çdo punëmarrëseje/punëmarrësi në sektorin publik dhe privat, në trajnime të detyruara për dhunën dhe diskriminimin me bazë gjinore, ngacmimin dhe shqetësimin seksual.

3. Dispozitat e këtij ligji i shtrijnë efektet e tyre edhe tek të vetëpunësuarat/vetëpunësuarit, si dhe për punëmarrëset/punëmarrësit për punët që kryhen në kushtet e shtëpisë.

Neni 28

Autoriteti publik përgjegjës për barazinë gjinore në fushën e punës

1. Ministria, që mbulon çështjet e punës dhe të punësimit, është autoriteti publik përgjegjës për të zbatuar dhe kontrolluar respektimin e këtij ligji në fushën e punës dhe të punësimit dhe për çështjet e barazisë gjinore në fushën e punës e të punësimit bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore.

2. Me qëllim që të zbatojnë masat për përmirësimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave dhe burrave, për eliminimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, për shkak të përkatësisë gjinore apo të përkatësisë së shumëfishtë e të ndërthurur, ministria që mbulon fushën e punës dhe të punësimit organizon mbikëqyrjen dhe bashkërendimin me institucionet në varësi në lidhje me çështjet e barazisë gjinore si më poshtë:

a) Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive siguron zbatimin e masave për mbikëqyrjen e mundësive dhe të trajtimit të barabartë ndërmjet grave dhe burrave në fushën e shërbimit të punësimit dhe të formimit profesional, përmes programeve aktive të tregut të punës, përmes trajnimit dhe zhvillimit të aftësive profesionale, si dhe në mbështetjen me të ardhura nga papunësia, kontrollon marrjen dhe zbatimin e masave të veçanta, të përkohshme nga punëdhënësja/ punëdhënësi, si dhe i paraqet ministres/ ministrit, që mbulon çështjet e barazisë gjinore, propozime për ndryshime në ligje e akte nënligjore, çdo nismë e projekte, studime e bashkëpunime të tjera në fushën e barazisë gjinore;

b) inspektorati përgjegjës për punën siguron kontrollin dhe zbatimin e masave për respektimin e barazisë gjinore në fushën e marrëdhënieve të punës e të punësimit, sigurisë në punë prej punëdhënëses/ punëdhënësit dhe personave të punësuar në sektorin publik e privat, inspekton përqendrimin e njërës gjini në vende pune me paga më të ulëta ose të punësimit informal dhe respektimin, sipas rastit, e rregullave që mundësojnë ekuilibrin punë–familje, si dhe kontrollon marrjen dhe zbatimin e masave të veçanta të përkohshme nga punëdhënësja/ punëdhënësi.

3. Ministria përgjegjëse për çështjet e punës dhe të punësimit bashkëpunon me:

a) institucionet përgjegjëse për sigurimet shoqërore me qëllim që të sigurojë zbatimin e masave për mbikëqyrjen e barazisë gjinore në fushën e administrimit dhe të menaxhimit të sistemit publik të pensioneve dhe të të drejtave të tjera të sigurimit shoqëror;

b) institucionet përgjegjëse për aftësimin dhe formimin profesional, me qëllim që të sigurojë barazinë gjinore në politikat dhe programet e aftësimit dhe formimit profesional, përfshirë ofrimin e bursave për ndjekjen e programeve të aftësimit dhe formimit profesional, inspektimin e ofruesve të aftësimit dhe formimit profesional, siguron kontrollin dhe zbatimin e masave për respektimin e barazisë gjinore në fushën e aftësimit e të formimit profesional si dhe hartimin e kurrikulave e të programeve të aftësimit e të formimit profesional me ndjeshmëri gjinore.

4. Mënyrat, format dhe fushat konkrete të bashkëpunimit në fushën e punës dhe të punësimit ndërmjet institucioneve në varësi të ministrisë, që mbulon çështjet e punës e të punësimit, dhe ministrive të tjera përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 29

Njoftimet diskriminuese

1. Përbën diskriminim një njoftim pune, arsimimi, kualifikimi ose trajnimi, kur në të përcaktohen kërkesa ose preferenca, të cilat i japin përparësi aplikueses/aplikuesit të një gjinie të caktuar, me përjashtim të rasteve të veçanta të përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji, për shkak të natyrës së veçantë të punës.

2. Përbën diskriminim një njoftim pune/ arsimimi, i cili përmban kërkesa që nuk kanë lidhje me vendin e punës/arsimit ose që mund të përjashtojë një grua/burrë apo një të re/të ri nga aplikimi ose që të lë përshtypjen e parapëlqimeve

ndaj një gjinie të caktuar, përveçse për shkaqe objektive dhe të arsyeshme.

3. Përbën diskriminim specifikimi në njoftim i kërkesave ose parapëlqimeve, që kanë të bëjnë me gjendjen familjare dhe martesore apo me detyrimet familjare. Në njoftimet e punës është e ndaluar të kërkohet nga njoftuesja/njoftuesi informacion rreth jetës private ose familjare të aplikueses/aplikuesit.

4. Njoftimi nuk është diskriminues nëse gjinisë së përfaqësuar në nivelin më të ulët (duke pasur parasysh vendin e punës dhe pozicionin) i jepet përparësi në njoftim.

5. Rregullimet në këtë nen nuk përjashtojnë ato të parashikuara në Kodin e Punës dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 30

Të drejtat e punëmarrëses/punëmarrësit për respektimin e parimeve të barazisë gjinore

Kushdo ka të drejtë që pa asnjë diskriminim për shkak të gjinisë:

a) të zgjedhë lirisht profesionin dhe vendin e punës, sistemin e përgatitjes profesionale dhe të kualifikimit të pandërprerë, të mësimit të profesioneve, të ngrihet në përgjegjësi, të ketë punë të qëndrueshme;

b) të ketë të njëjtat mundësi punësimi, përfshirë zbatimin e të njëjtave kritere të përzgjedhjes për punësim;

c) të informohet nga punëdhënësja/punëdhënësi për vendet e lira të punës dhe të drejtat e tyre mbi mundësitë e barabarta në marrëdhëniet e punës;

ç) të ketë pagë të barabartë për punë me vlerë të barabartë, përfshirë shpërblimet, për trajtim të barabartë për punë me vlerë të barabartë, si dhe për trajtim të barabartë lidhur me vlerësimin e cilësisë së punës;

d) të ketë sigurime shoqërore, veçanërisht në rastet e daljes në pension, të papunësisë apo të humbjes së aftësisë së përkohshme për punë;

dh) të gëzojë mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë në punë, përfshirë ruajtjen e funksionit të riprodhimit;

e) të mos diskriminohet ose të pushohet nga puna për shkak të martesës ose gratë për shkak të shtatzënisë ose amësisë dhe të garantohet e drejta efektive për punë;

ë) të ketë të drejtë të përfitojë kompensime për fëmijët që kanë në ngarkim;

f) të ketë mbështetjen dhe inkurajimin e sistemit të shërbimeve sociale të nevojshme për t'u lejuar prindërve punëmarrës të gërshetojnë detyrimet familjare me përgjegjësitë profesionale;

g) të trajnohet dhe të ritrajnohet, të ketë aftësim dhe formim profesional;

gj) të marrë informacion me shkrim nga punëdhënësja/punëdhënësi pas paraqitjes së një kërkese lidhur me natyrën dhe qëllimin e trajnimit, eksperiencën në punë dhe kualifikimet e tjera që pati personi i gjinisë tjetër, i cili fitoi të drejtën, u përzgjodh, u promovua në një pozicion ose vend të lirë pune;

h) të anëtarësohet, të aktivizohet dhe të mbajë pozicione vendimmarrëse në organizatat sindikale dhe në çdo organizatë tjetër profesionale.

Neni 31

Masat e veçanta të përkohshme në fushën e marrëdhënieve të punës

1. Për të siguruar përfaqësim të barabartë në fushën e marrëdhënieve të punës nuk përbën diskriminim nëse shpallja për një vend të lirë pune deklaron parapëlqim për kandidaten/kandidatin e gjinisë më pak të përfaqësuar, në respektim të pikës 2 të këtij neni, me qëllim korrigjimin e pabarazive ekzistuese në përfaqësim dhe arritjen e barazisë gjinore në punë.

2. Për të siguruar përfaqësim të barabartë e gjithëpërfshirës në fushën e marrëdhënieve të punës, në procesin e përzgjedhjes për marrjen në punë, ngritjen në detyrë, zhvillimin e aftësive profesionale, kur kandidatet/kandidatët kanë rezultate ose nivele të barabarta, punëmarrësja/punëmarrësi i jep përparësi kandidates/kandidatit të gjinisë më pak të përfaqësuar.

Neni 32

Vlerësimi i punës së papaguar

1. Puna e papaguar vlerësohet kontribut për zhvillimin e familjes dhe të shoqërisë, kur gratë dhe burrat:

a) kujdesen për mirëqenien e familjes;

b) kujdesen për fëmijët;

c) kujdesen për anëtare/anëtarë të tjerë të familjes;

ç) punojnë në bujqësi dhe ekonomi familjare.

2. Subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni përfitojnë nga shërbimet në komunitet, politikat e kujdesit shëndetësor dhe sociale, politikat e punës dhe të punësimit, si dhe të aftësimit e të formimit profesional, në bazë të legjislacionit në fuqi.

3. Institucionet publike hartojnë dhe miratojnë politika për shërbime publike, infrastrukturore, teknologjike, të kujdesit social, për fëmijët dhe për personat e moshës së tretë, për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të tjerë që kanë nevojë për kujdes, përmes përshtatjes së rregullave për punën e papaguar të grave dhe burrave.

4. Institucionet publike hartojnë dhe miratojnë politika për balancën punë-jetë duke nxitur pjesëmarrjen e grave e të të rejave në tregun e punës, ndërgjegjësimin për ndarjen e barabartë të përgjegjësive të kujdesit midis burrave dhe grave, duke marrë masa për eliminimin e hendekut gjinor në të ardhura dhe paga, si dhe zbatimin e tyre nga subjektet private.

5. Punëdhënëset/punëdhënësit publikë dhe privatë rishikojnë rregullat e punësimit, dispozitat e kontratave individuale dhe kolektive të punës, me qëllim përfshirjen e rregullave për orare fleksibël dhe të reduktuara pune, si dhe kryerjen e punës në distancë.

6. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrisë përgjegjëse në fushën e punës e të punësimit dhe ministrisë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore, merr masa për hartimin e politikave dhe rishikimin e legjislacionit për parashikimin e rregullimeve fleksibël ose me orare të reduktuara pune për prindërit, kujdestaret/kujdestarët deri në një moshë të caktuar të fëmijës dhe anëtaret/anëtarët e tjerë të familjes që përkujdesen për të afërmet/afërmit.

7. Instituti i Statistikave, jo më pak se një herë në 4 vjet, publikon anketën e harmonizuar për përdorimin e kohës.

8. Ngarkohet ministria përgjegjëse për çështjet e punës dhe ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore të hartojnë udhëzimin e përbashkët për përmbajtjen dhe masat që duhet të merren nga subjektet publike dhe private për të adresuar punën e papaguar në zbatim të këtij neni.

KREU VI
TRAJTIMI I BARABARTË DHE MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJINISË DHE PËRKATËSISË SË SHUMËFISHTË NË SEKTORË TË VEÇANTË

Neni 33
Edukimi i barazisë gjinore

1. Subjektet, që ofrojnë arsimim të përgjithshëm dhe profesional, kualifikim e trajnim, si dhe ata që hartojnë dhe miratojnë tekstet, programet dhe materialet e tjera mësimore, në të gjitha nivelet, sigurojnë përfshirjen e edukimit gjinor në kurrikulat shkollore dhe mësimdhënien e njohurive të nevojshme të koncepteve themelore që lidhen me individët dhe grupet dhe përdorin metoda mësimdhënieje, trajnimi e kualifikimi, në mënyrë të tillë që të ndihmojnë në promovimin, nxitjen dhe formimin e edukatës së barazisë dhe në ndalimin e diskriminimit me bazë gjinore, të stereotipave gjinorë, paragjykimeve dhe praktikave të dëmshme zakonore, pabarazive gjinore për shkak të përkatësisë së shumëfishtë ose të çdo lloji tjetër që cenojnë parimet e barazisë gjinore.

2. Institucionet në fushën e arsimit parauniversitar dhe institucionet në fushën e arsimit profesional, arsimit të përgjithshëm e atij profesional dhe teknologjisë së informacionit, sipas fushave përkatëse, ndërmarrin nisma për kryerjen e studimeve në fushën e barazisë gjinore dhe e përfshijnë barazinë gjinore në studimet që realizohen, për të siguruar integrimin gjinor, si dhe të dhëna të ndara sipas seksit, statistikave gjinore dhe treguesve gjinorë, me qëllimin për t'i paraprirë zhvillimit ligjor, praktik e shkencor të barazisë gjinore.

Neni 34
Ndalimi i pabarazisë për shkak të gjinisë e përkatësisë së shumëfishtë në arsim të përgjithshëm dhe profesional, shkencën dhe kërkim shkencor, formim profesional dhe zhvillim teknologjik

1. Ndalohet diskriminimi për shkak të gjinisë dhe përkatësisë së shumëfishtë në arsim të përgjithshëm dhe profesional, shkencën dhe kërkim shkencor, formim profesional dhe zhvillim teknologjik.

2. Përbëjnë diskriminim rastet kur parashikohen norma kufizuese dhe pengohet krijimi i lehtësive të nevojshme për t'u arsimuar dhe formuar profesionalisht, bazuar në dallime gjinore apo të përkatësisë së shumëfishtë me qëllim pengimin e arritjeve të barazisë gjinore, tejkalimin e stereotipave dhe paragjykimeve gjinore dhe përmbajtjeve seksiste, nxitjen e respektit të ndërsjellë ndaj dinjitetit dhe integritetit personal, parandalimin dhe luftën ndaj dhunës me bazë gjinore, të përshtatura sipas grup-moshave, në të gjitha nivelet e edukimit, shkencës dhe kërkimit shkencor dhe kualifikimit.

3. Subjektet që zhvillojnë veprimtari arsimore të përgjithshme dhe profesionale, të kualifikimit profesional, shkencor dhe të zhvillimit teknologjik, marrin masat e përshtatshme për të krijuar lehtësitë e nevojshme dhe të përligjura objektivisht për arritjen e barazisë gjinore dhe për mundësi dhe akses të barabartë gjinor në fushën e veprimtarisë së tyre.

4. Për arritjen e barazisë gjinore në fushat e veprimtarisë arsimore të përgjithshme dhe profesionale, të kualifikimit profesional, shkencor dhe të zhvillimit teknologjik, ministria/të përgjegjëse për arsimin, shkencën dhe kërkimin shkencor, formimin profesional dhe zhvillimin teknologjik hartojnë, mbështesin dhe subvencionojnë përmes buxhetit të shtetit, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore, programe të posaçme për arritjen e barazisë gjinore në arsimin e përgjithshëm dhe profesional, shkencë, formim profesional dhe zhvillim teknologjik.

5. Subjektet që zhvillojnë veprimtari arsimore dhe kërkimore-shkencore, veprimtari të formimit teknologjik dhe të zhvillimit teknologjik:

a) marrin masa për arritjen dhe përmirësimin e barazisë gjinore gjatë miratimit dhe zbatimit të planeve, programeve, teksteve dhe materialeve, metodave dhe mjeteve të arsimimit të përgjithshëm e profesional dhe formimit dhe sigurojnë integrimin e barazisë gjinore në përmbajtjen e tyre, nxisin barazinë gjinore dhe rrisin dukshmërinë, qasjen e kontributin gjinor në arsimin e përgjithshëm e profesional, formim profesional, shkencë dhe kërkim shkencor, zhvillim teknologjik dhe në çdo fushë veprimtarie;

b) sigurojnë mbështetje me fonde publike për programet arsimore, të formimit profesional dhe zhvillimit teknologjik, projektet kërkimore-shkencore, me qëllim arritjen e barazisë gjinore, si dhe pjesëmarrje të barabartë gjinore në grupet e vlerësimit të tyre;

c) marrin masa që punonjëset/punonjësit e tyre të trajnohen periodikisht për barazinë gjinore, ndalimin e diskriminimit gjinor e për shkak të përkatësisë së shumëfishtë, si dhe dhunës me bazë gjinore;

ç) vlerësojnë periodikisht integrimin e barazisë gjinore në përmbajtjen e teksteve dhe materialeve të tjera mësimore të edukimit;

d) nxisin pjesëmarrjen dhe regjistrimin e balancuar të gjinive në programe studimore të çdo niveli, programe të formimit profesional, përfitimet e bursave dhe programet e të mësuarit gjatë të gjithë jetës.

Neni 35

Barazia gjinore në fushën e teknologjive të informacionit dhe komunikimit, dhe të shoqërisë së informacionit

Ministria përgjegjëse për fushën e teknologjive të informacionit dhe komunikimit dhe të shoqërisë së informacionit, si dhe subjektet e tjera publike dhe private:

a) promovojnë përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit dhe shoqërisë së informacionit pa dallime gjinore dhe marrin masa për të parandaluar dhe eliminuar diskriminimin gjinor dhe për shkak të përkatësisë së shumëfishtë dhe dhunën me bazë gjinore që ndodh përmes ose përforcohet prej përdorimit të teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe shoqërisë së informacionit dhe/ose inteligjencës artificiale (AI);

b) mbështetin me fonde publike programe që kontribuojnë në promovimin e barazisë gjinore dhe eliminimin e stereotipave gjinorë në fushën e teknologjive të informacionit, komunikimit dhe shoqërisë së informacionit;

c) promovojnë në bashkëpunim me ministritë përgjegjëse në fushën e arsimit të përgjithshëm dhe profesional, si dhe formimit profesional njohuritë e aftësitë digjitale dhe inteligjencën artificiale, pa dallime gjinore, me qëllim përfaqësimin gjithëpërfshirës e të balancuar gjinor në tregun digjital të punës.

Neni 36
Barazia gjinore në informimin publik dhe media

1. Ndalohen transmetimi, botimi dhe/ose publikimi i materialeve dhe i informacioneve që përmbajnë, nënkuptojnë ose përbëjnë diskriminim për shkak të gjinisë, përkatësisë së shumëfishtë dhe/ose dhunës me bazë gjinore.

2. Subjektet publike dhe private në fushën e informimit publik dhe medias marrin masa për:

a) eliminimin e përmbajtjeve të informimit publik dhe mediatik, përfshirë reklamat dhe përmbajtjet e platformave të shpërndarjes së komunikimeve dhe videove, që krijojnë ose nxisin diskriminimin bazuar në gjini apo për shkak të përkatësisë së shumëfishtë dhe/ose dhunës me bazë gjinore, si dhe përdorimin e gjuhës së ndjeshme gjinore në informimin publik e mediatik;

b) ndalimin e gjuhës seksiste, gjuhës së urrejtjes, eliminimin e stereotipave gjinorë, paragjykimeve, zakoneve ose modeleve të sjelljeve shoqërore diskriminuese të njërës gjini dhe epërsisë së tjetrës;

c) qasje të barabartë gjinore në politikat që mbështesin krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve mediatike dhe programet e informimit publik dhe mediatik;

ç) ndërgjegjësimin përmes informimit publik dhe mediatik për arritjen e barazisë gjinore dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore në familje, vendin e punës dhe shoqëri.

Neni 37
Barazia gjinore në sektorët e bujqësisë dhe zhvillimit rural

1. Subjektet publike dhe private marrin masa të përshtatshme për zbatimin e këtij ligji me qëllim integrimin gjinor dhe zbatimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në veprimtari të ndryshme, të qëndrueshme dhe inovative bujqësore dhe të zhvillimit rural.

2. Ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore, njësitë e vetëqeverisjes vendore, dhe sipas rastit, edhe me ministri të tjera:

a) ndërmarrin nisma ligjore për njohjen e punës së grave në zonat rurale, aksesin në kredi dhe ndihma bujqësore, parashikimin e lehtësive në tregti, në fushën e mbrojtjes shoqërore dhe në fusha të tjera sipas nevojës;

b) përfshijnë në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore objektiva të posaçëm për arritjen e barazisë gjinore në zonat bujqësore dhe rurale;

c) hartojnë programe për integrimin e grave në zonat rurale në tregun e punës, zhvillimin e aftësive të tyre sipërmarrëse, përfshirë në turizmin rural, edukimin dhe formimin profesional të tyre;

ç) parashikojnë mbështetje të posaçme për gratë në skemat e administrimit të fondit të Programit Kombëtar të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

d) bashkëpunojnë për ofrimin në zonat bujqësore dhe rurale të edukimit e të formimit profesional cilësor, e aksesit në internet, teknologji dhe informacion, përmirësimin e infrastrukturës e të transportit, garantimin e furnizimit me ujë, energji elektrike dhe shërbime shëndetësore e të planifikimit familjar, shërbime të kujdesit shoqëror dhe të tjera sipas nevojës;

dh) nxisin ndërgjegjësimin me qëllim eliminimin e diskriminimit me bazë gjinore e për shkak të përkatësisë së shumëfishtë në zonat bujqësore dhe rurale dhe angazhimin gjithëpërfshirës e të barabartë gjinor në grupet vendore të veprimit.

3.Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore, në përputhje me pikën 2 të nenit 18 të këtij ligji, shqyrton të paktën në një nga mbledhjet e veta vjetore masat e marra, përparimin dhe nevojat për zbatimin e këtij ligji në zonat bujqësore dhe rurale.

Neni 38
Barazia gjinore në sport dhe veprimtari sportive

Ministria përgjegjëse për sportin, si dhe cilido subjekt publik dhe privat marrin masa për arritjen e barazisë gjinore në sport dhe veprimtari sportive sipas interesave, nevojave dhe prioriteteve të ndryshme gjinore nëpërmjet:

a) promovimit të aksesit të barabartë gjinor në politikat, programet, shërbimet, menaxhimit të burimeve njerëzore dhe tregut të punës në sport dhe veprimtari sportive;

b) miratimit të programeve sportive të financuara nga fondet publike që promovojnë barazinë gjinore dhe luftën kundër stereotipave gjinorë në sport dhe veprimtari sportive;

c) eliminimit të stereotipave gjinorë, seksizmit, dhunës dhe diskriminimit me bazë gjinore e për

shkak të përkatësisë së shumëfishtë në modelet, zakonet, praktikat dhe përdorimit të gjuhës në sport dhe veprimtari sportive, si dhe promovimit të imazheve dhe roleve jostereotipe në sport dhe veprimtaritë sportive;

ç) përdorimit të gjuhës së ndjeshme gjinore në veprimtaritë sportive dhe raportimin e tyre;

d)realizimit të studimeve, shkencës dhe kërkimit shkencor për pjesëmarrjen dhe kontributin sipas gjinisë në sport dhe veprimtari sportive.

Neni 39

Barazia gjinore në fushën e mbrojtjes sociale dhe të shëndetësisë

Ministritë përgjegjëse në fushën e mbrojtjes sociale dhe të shëndetësisë, si dhe subjektet publike dhe private, që ushtrojnë veprimtari në fushën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, shërbimet e kujdesit shoqëror dhe shëndetësor marrin masa:

a) për gëzimin e të drejtave dhe trajtimin në mënyrë të barabartë, pavarësisht përkatësisë gjinore apo të shumëfishtë e të ndërthurur, në fushën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe shëndetësor;

b) për trajtimin e barabartë, pavarësisht përkatësisë gjinore apo të shumëfishtë e të ndërthurur, nga sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, përfshirë kushtet e aksesit, kontributet dhe llogaritjen e përfitimeve nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi;

c) për të siguruar që gratë e punësuara në bizneset familjare të kenë akses në skemat e sigurimeve shoqërore;

ç) për qasje të bazuara në nevojat dhe prioritetet e ndryshme të grave e të burrave në kontrolle të rregullta mjekësore dhe programe vaksinimi;

d) për edukimin e ndërgjegjësimin, pavarësisht gjinisë, për kujdesin shëndetësor, shëndetin seksual e riprodhues dhe shërbimet shëndetësore;

dh) për vlerësimin e ndikimit gjinor të emergjencave shëndetësore dhe masat për zgjidhjen e tyre.

Neni 40

Barazia gjinore në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë

Ministria përgjegjëse në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe subjektet publike dhe private, që ushtrojnë veprimtari në këto fusha, me qëllim arritjen e integrimit dhe barazisë gjinore, marrin masa për:

a) zhvillimin e mekanizmave parandalues për rritjen e sigurisë gjinore në situatë paqeje, konflikti dhe paskonflikti dhe në situata krize e emergjence, brenda dhe jashtë vendit;

b) garantimin e një përfaqësimi të balancuar gjinor e gjithëpërfshirës në vendimmarrje në të gjitha proceset e paqes, mbrojtjes dhe sigurisë;

c) miratimin e politikave e të planeve të veprimit për agjendën "Gruaja, paqja, siguria";

ç) sigurimin e politikave të përgjegjshme gjinore për azilkërkueset/azilkërkuesit;

d) kryerjen e analizave të ndjeshme dhe të përgjegjshme gjinore në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë;

dh) vendosjen e mekanizmave për raportimin anonim të dhunës ose diskriminimit;

e) përfshirjen e grave në negociatat për paqe dhe proceset e rindërtimit pas konfliktit;

ë) mbështetjen e grave për të marrë role udhëheqëse në forcat e sigurisë, politikë dhe qeverisje;

f) mbështetje për fuqizimin ekonomik të grave në zona konflikti ose krize;

g) sigurimin e mbështetjes për shëndetin mendor dhe fizik të grave e të vajzave;

gj)sigurimin që ndihma humanitare të jetë e ndjeshme ndaj dimensioneve gjinore;

h) zbatimin e programeve ndërkombëtare për mbrojtjen gjinore në kontekste konflikti dhe emergjence;

i) vlerësimin e përparimeve dhe sfidave në rritjen e sigurisë gjinore;

j) masa të integruara në të gjitha nivelet dhe të zbatuara nga qeveritë, organizatat ndërkombëtare dhe shoqëria civile për të siguruar një mjedis të sigurt dhe gjithëpërfshirës për të gjitha gjinitë;

k) hartimin e planeve kombëtare që promovojnë barazinë gjinore dhe mbrojnë të drejtat e grave e të vajzave;

l) organizimin e fushatave me qëllim ndërtimin e kulturës së respektit dhe barazisë gjinore;

ll) organizimin e trajnimeve për institucionet dhe organizatat me qëllim edukimin e zyrtarëve publikë, forcave të sigurisë dhe organizatave joqeveritare për çështjet gjinore dhe protokollet për parandalimin e dhunës.

Neni 41
Barazia gjinore në fushën e transportit, infrastrukturës dhe planifikimit urban

Ministria/të përgjegjëse në fushën e transportit, menaxhimit të transportit, infrastrukturës dhe planifikimit urban, si dhe subjektet publike dhe private, që ushtrojnë veprimtari në këto fusha, me qëllim arritjen e integrimit gjinor dhe barazisë gjinore, marrin masa për:

a) integrimin e perspektivës gjinore në politikat e transportit, infrastrukturës dhe planifikimit urban;

b) garantimin e aksesit pa dallime gjinore në punë, arsim, kujdes shëndetësor dhe shërbime të tjera publike, përmes lehtësive në fushën e transportit, infrastrukturës dhe planifikimit urban;

c) eliminimin e barrierave me qëllim garantimin e shërbimeve të transportit të sigurt, pa diskriminim gjinor, dhunë dhe ngacmim seksual me bazë gjinore;

ç) kryerjen e analizave dhe studimeve të ndjeshme e të përgjegjshme gjinore për ndikimin e transportit, infrastrukturës dhe planifikimit urban në pabarazitë gjinore dhe cenimin e integrimit gjinor.

Neni 42
Barazia gjinore në fushën e energjisë

Ministria/të përgjegjëse në fushën e energjisë, si dhe subjektet publike dhe private, që ushtrojnë veprimtari në këtë fushë, me qëllim eliminimin e pabarazisë gjinore, arritjen e integrimit dhe barazisë gjinore, marrin masa për:

a) integrimin gjinor në politikat, programet dhe shërbimet në fushën e energjisë dhe të energjisë së rinovueshme;

b) vlerësimin e interesave, nevojave dhe prioriteteve të ndryshme, sipas përkatësisë gjinore, të konsumatoreve/konsumatorëve të energjisë në procesin e menaxhimit të energjisë dhe të burimeve energjetike;

c) kryerjen e investimeve në fushën e energjisë dhe të energjisë së rinovueshme që korrigjojnë pabarazitë gjinore;

ç) realizimin e analizave, shkencës dhe kërkimeve e studimeve shkencore periodike për ndikimin e energjisë dhe të mungesës së saj ndaj gjinive.

Neni 43
Barazia gjinore në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të burimeve natyrore

Ministria përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e burimeve natyrore, si dhe subjektet publike dhe private, që ushtrojnë veprimtari në këtë fushë, me qëllim eliminimin e pabarazisë gjinore dhe arritjen e integrimit dhe barazisë gjinore, marrin masa për:

a) miratimin e politikave, të programeve dhe të shërbimeve të përgjegjshme gjinore në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të burimeve natyrore që respektojnë parimin e qasjes mjedisore të integruar, pavarësisht përkatësisë gjinore;

b) garantimin e së drejtës për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjes së tij, si dhe zbatimit të normave të cilësisë së mjedisit, pa dallime gjinore;

c) financimin e qëndrueshëm pa dallime gjinore të *startup*-eve dhe/ose sipërmarrjeve "të gjelbërta";

ç) integrimin gjinor në planet e veprimit për mjedisin dhe për rastet e fatkeqësive natyrore;

d) menaxhimin me përgjegjshmëri gjinore të burimeve ujore, sidomos të ujit të pijshëm dhe të burimeve të tjera natyrore;

dh) realizimin e analizave, shkencës dhe kërkimeve e studimeve shkencore periodike për ndikimin ndaj gjinive të ndotjes së ajrit, ndotjes së zinxhirit ushqimor, si dhe çdo ndotjeje mjedisore, të shpyllëzimit, degradimit të tokës, shkretëtirëzimit, mungesës së ujit, kanalizimit të pamjaftueshëm, situatave të emergjencave mjedisore, katastrofave natyrore dhe ndryshimeve klimaterike.

Neni 44
Barazia gjinore në fushën e kulturës dhe artit

Ministria përgjegjëse për fushën e kulturës dhe artit, si dhe subjektet publike dhe private, që ushtrojnë veprimtari në këto fusha, me qëllim eliminimin e pabarazisë gjinore për shkak të përkatësisë së shumëfishtë dhe arritjen e integrimit dhe barazisë gjinore, marrin masa për:

a) garantimin e lirisë së krijimtarisë kulturore dhe artistike, aksesit dhe mundësive të barabarta në manifestimin dhe zhvillimin e talenteve në krijimtarinë artistike dhe kulturore, pavarësisht përkatësisë gjinore apo asaj të shumëfishtë;

b) mbështetjen e projekteve dhe dhënien e çmimeve në fushën e kulturës dhe artit, pa diskriminim gjinor apo për shkak të përkatësisë së shumëfishtë;

c) parandalimin dhe eliminimin e dhunës me bazë gjinore në fushën e kulturës dhe artit, si dhe nxitjes së dhunës me bazë gjinore përmes kulturës dhe artit;

ç) realizimin e studimeve për ndikimin e kulturës dhe artit ndaj gjinive dhe për kontributin gjinor në zhvillimin e kulturës dhe artit.

KREU VII
MASAT DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 45
Masat e zbatueshme

1. Masat e përcaktuara në këtë ligj për arritjen e barazisë gjinore nuk përjashtojnë zbatimin e masave të përcaktuara në ligje të tjera për këtë çështje.

2. Çdo masë e dhënë, sipas këtij ligji, shoqërohet edhe me detyrimin e ndreqjes së shkeljes dhe zhdukjes së shkaqeve që cenojnë parimin e barazisë gjinore, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Neni 46
Masat disiplinore

1. Shkelja e dispozitave të këtij ligji është shkak për përgjegjësi disiplinore.

2. Masat disiplinore jepen nga eprorja/eprori i drejtpërdrejtë, organi apo strukturat përkatëse kompetente të subjektit publik ose privat në të cilin është e/i punësuar punonjësja/punonjësi që shkel dispozitat e këtij ligji, në përputhje me legjislacionin përkatës për marrëdhënien e punës.

3. Procedimi disiplinor për shkeljet e këtij ligji fillon me kërkesën e palës që pretendon se i janë cenuar të drejtat sipas këtij ligji ose nga eprorja/eprori i drejtpërdrejtë, organi apo strukturat përkatëse kompetente për dhënien e masave disiplinore subjektit publik ose privat.

4. Në rastet kur ka një vendim administrativ apo vendim gjykate të formës së prerë për shkeljen e dispozitave të këtij ligji nga një punonjëse/punonjës, eprorja/eprori i drejtpërdrejtë, organi apo strukturat përkatëse kompetente kanë detyrimin e fillimit të procedimit disiplinor ndaj këtij/kësaj punonjëseje/punonjësi.

5. Në rastet kur ka një vendim administrativ apo vendim gjykate të formës së prerë për shkeljen e dispozitave të këtij ligji, organi apo strukturat përkatëse kompetente për dhënien e masës disiplinore të subjektit publik ose privat marrin masa për zbatimin e vendimit përkatës.

6. Vendimi për masën disiplinore regjistrohet në regjistrin përkatës të punës të subjektit publik dhe privat.

Neni 47
Sanksionet

1. Shkelja e neneve 24 deri 30 të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet nga inspektorati përgjegjës për punën në përputhje me ligjin për inspektimin në fuqi dhe/ose, sipas rastit, nga Komisionerja/Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në përputhje me ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

2. Shkelja e neneve 33 deri 44 të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, inspektorati përgjegjës për punën, në përputhje me ligjin për inspektimin në fuqi dhe/ose, sipas rastit, nga Komisionerja/Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

3. Masa e gjobës për shkeljet e këtyre dispozitave është si më poshtë:

a) personi fizik dënohet me gjobë nga 60 000 deri 120 000 lekë;

b) personi juridik dënohet me gjobë nga 120 000 deri 200 000 lekë;

c) personi fizik brenda personit juridik, i cili është përgjegjës për shkeljen, dënohet me gjobë nga 60 000 deri 160 000 lekë;

ç) personi, i cili ushtron funksion publik dhe është përgjegjës për shkeljen në bazë të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 60 000 deri 160 000 lekë.

4. Për shkeljet e dispozitave të këtij ligji nga partitë politike zbatohen dispozitat e legjislacionit zgjedhor në fuqi.

5. Gjobat sipas këtij neni përbëjnë titull ekzekutiv.

6. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, në rastet kur përbëjnë vepër penale, dënohen sipas dispozitave të Kodit Penal në fuqi.

Neni 48
Shpërblimi i dëmit

1. Kushdo që pretendon se është trajtuar në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë apo me parimin e mosdiskriminimit për shkak të gjinisë sipas këtij ligji, ka të drejtën të paraqesë kërkesë pranë organeve publike dhe/ose kërkesë padi në gjykatë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor.

2. Shpërblimi i dëmit jashtëkontraktor përfshin kompensimin për dëmet pasurore dhe jopasurore, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe pasojave përkatëse, përmes kthimit në gjendjen e mëparshme, zhdukjen e shkaqeve që sjellin dëmin ose masave të tjera të përshtatshme.

Neni 49
Procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

1. Çdo ankesë për shkeljen e barazisë gjinore, sipas këtij ligji, shqyrtohet ose gjykohet nga organet publike dhe subjektet private, përkatësisht, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi, Kodit të Punës dhe legjislacionit në fuqi. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës merren masa sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Ankuesja/ankuesi mund të paraqesë ankesë për trajtim në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë sipas këtij ligji, sipas rastit, para organeve publike ose organeve të subjekteve private, ndaj të cilëve ngrihet pretendimi, ose pranë Komisioneres/ Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ankesa paraqitet me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, dhe në këtë rast mbahet procesverbal. Kur pala paraqet fakte, nga të cilat mund të supozohet se i janë cenuar të drejtat sipas këtij ligji, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, i takon palës tjetër dhe/ose organit publik të provojë se faktet nuk përbëjnë trajtim jo të barabartë. Organet publike, organet e subjekteve private dhe Komisionerja/Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi kanë detyrimin të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej tyre.

3. Ankimi sipas pikës 1 të këtij neni nuk i heq të drejtën ankueses/ankuesit të paraqesë kërkesëpadi pranë gjykatës kompetente. Gjykata shqyrton çështjen sipas parimit të kalimit të barrës së provës, sipas së cilës kur pala paraqet fakte nga të cilat mund të supozohet se i janë cenuar të drejtat sipas këtij ligji në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, i takon palës tjetër të provojë se faktet nuk përbëjnë trajtim jo të barabartë.

4. Palët, me vullnetin e tyre të lirë, kur është rasti, mund të zgjidhin mosmarrëveshjet në bazë të këtij ligji, sipas procedurave të ndërmjetësimit ose zgjidhjes me pajtim, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

5. Organizatat me interesa legjitime mund të përfaqësojnë, të mbështesin apo t'u japin ndihmën e tyre palëve në procese ligjore, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe të legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi.

KREU VIII
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 50
Shfuqizimet

Ligji nr. 9970, datë 24.7.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri", dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij shfuqizohen.

Neni 51
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet ministrja/ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore dhe ministrja/ministri përgjegjës për çështjet e punës për nxjerrjen e udhëzimit në zbatim të nenit 32, pika 8, të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

2. Ngarkohet Kryeministri të miratojë urdhrin sipas pikës 5, të nenit 13 të këtij ligji brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

3. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 10, pika 4; nenit 11, pika 2; nenit 13, pika 5; nenit 18, pika 7; nenit 20, pika 2; neni 28, pika 4, dhe nenit 32, pika 8, të këtij ligji brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 52
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 6.11.2025.

VENDIM
Nr. 733, datë 3.12.2025

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË AGJENDËS DIGJITALE PËR ARSIMIN 2025–2030, DUKE PËRFSHIRË STANDARDET PËR ARRITJEN E KOMPETENCËS DIGJITALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të veprimit të Agjendës Digjitale për Arsimin 2025–2030, duke përfshirë standardet për arritjen e kompetencës digjitale, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe të gjitha institucionet përgjegjëse të përmendura në tekstin e këtij plani veprimi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLANI I VEPRIMIT I AGJENDËS DIGJITALE PËR ARSIMIN 2025–2030
____, 2025

Përmbajtja

Sfondi dhe konteksti
Metodologjia
Kapitulli 1: Situata aktuale 7
Kapitulli 2: Vizioni, politikat dhe objektivat e politikave
A. Vizioni
B. Politikat dhe objektivat e politikave
1. Zgjerimi i Laboratorëve Inteligjentë *(SmartLabs)* në të gjitha shkollat deri në vitin 2027
2. Blerja e 5,500 laptopëve për mësuesit e gjimnazeve
3. Vazhdimi i zgjerimit të lidhjes me brez të gjerë *(Broadband)* dhe Wi-Fi me shpejtësi të lartë në të gjitha shkollat
4. Krijimi i platformës kombëtare për menaxhimin e informacionit kërkimor shkencor (ACRIS)
5. Krijimi i një mekanizmi të zbatimit të planit të veprimit të agjendës digjitale për arsimin 15
6. Vendosja e standardeve të shkallëzuara për pajisjet digjitale dhe ndërlidhjen për institucionet e arsimit të lartë
7. Treguesit kombëtarë të arsimit dhe roli i tyre si pjesë e kuadrit të administrimit të të dhënave
8. Zhvillimi dhe zbatimi i udhëzimeve dhe rasteve praktike për përdorimin e IA-së gjeneruese (GenAI)
9. Zhvillimi i një plani për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për programe/kurse të teknologjisë së avancuar në Institucionet e arsimit të lartë
10. Përfshirja e Inteligjencës Artificiale në kurrikulën e TIK-ut në arsimin parauniversitar
11. Zgjerimi i trajnimeve në TIK për të gjithë mësuesit dhe ofrimi i mbështetjes për trajnime bazuar në vlerësime periodike
12. Lidhja e programeve të studimit në fushën e mësuesisë me kompetencat digjitale për mësuesit
13. Përditësimi i mekanizmit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional *online* (ZHP) për mësuesit
14. Vazhdimi i përmirësimit të gjithëpërfshirjes në arsimin digjital
15. Vazhdimi i përditësimit të kurrikulës dhe kompetencave të TIK-ut për arsimin parauniversitar
16. Zhvillimi dhe zbatimi i një programi edukimi për higjienën digjitale
17. Përdorimi efektiv i Laboratorëve Inteligjentë *(SmartLabs)*
18. Përditësimi i përmbajtjes digjitale në përputhje me kurrikulën e përditësuar
19. Krijimi i një udhërrëfyesi për të rritur vizibilitetin në internet të institucioneve të arsimit të lartë
20. Bashkëpunimi me Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës për përdorimin e teknologjisë në arsim
21. Organizimi i festivalit kombëtar për arsimin digjital
22. Krijimi i mekanizmave për njohjen e krediteve të programeve/kurseve specifike Kurse Masive të Hapura *Online*" (MOOCs) sipas kërkesës së tregut
Kapitulli 3: Burimet financiare
PLANI I ZBATIMIT – VLERËSIMI I KOSTOS/NDIKIMI NË BUXHET
MATRICA E REZULTATEVE

Sfondi dhe konteksti

Edukimi digjital nuk është më thjesht një vizion i së ardhmes; ai është bërë një domosdoshmëri. Pandemia e COVID-19 theksoi rëndësinë kritike të të pasurit mjedise të të mësuarit që janë fleksibël, të drejtuara nga teknologjia dhe të afta për të përballuar kufizimet dhe sfidat.



... drejta për një lidhje kuptimplotë me internetin dhe mësimdhënie digjitale është gjithnjë e më shumë sinonim i së drejtës për arsim...

Global Monitoring Report – GEM, UNESCO (2023)

Edukimi digjital mund të ndihmojë në krijimin e fleksibilitetit dhe të qëndrueshmërisë së sistemit, të përgatisë fuqinë punëtore të së ardhmes, të përmirësojë metodat e të nxënit përmes teknologjisë dhe të jetë kosto efektive në planin afatgjatë.

Shtetet në të gjithë botën po miratojnë gjithnjë e më shumë strategji dhe politika të edukimit digjital. Që nga viti 2020, afërsisht gjysma e vendeve të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) kishin strategji specifike për arsimin digjital (van der Vlies, 2020). Këto politika në përgjithësi ishin pjesë e strategjive më të gjera kombëtare të inovacionit digjital, që synonin pajisjen e brezit të ardhshëm me aftësitë dhe mjetet digjitale të nevojshme për të qenë të suksesshëm në një shoqërie digjitale me ritme të shpejta. Përhapja e COVID-19 vuri në dukje gjendjen aktuale të digjitalizimit dhe nxiti nisma shtesë për të përmirësuar arsimin digjital.

Singapori	EdTech Master Plan 2030	Sllovenia	Digital Education Action Plan (ANDI)	Spanja	Educa en Digital 2024-30
Finlanda	Policies for the Digitalization of Education & Training 2023-27	Franca	Digital Strategy for Education 2023 – 2027	Malta	Digital Education Strategy 2024 - 2030

Qeveria e Shqipërisë ka bërë përparim të rëndësishëm në përmirësimin e përdorimit dhe në rritjen e këtyre aftësive. E drejtuar nga vizioni i saj strategjik, Shqipëria ka përcaktuar prioritetet kryesore për të forcuar ofrimin dhe menaxhimin e arsimit digjital. Këto prioritete pasqyrohen në disa dokumente themelore, duke përfshirë:

- Strategjinë Kombëtare të Arsimit (2021–2026), miratuar me vendimin nr. 621, datë 22.10.2021, të Këshillit të Ministrave *"Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj";*
- Strategjinë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin (2023–2030), miratuar me vendimin nr. 542, datë 20.9.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj";
- Agjendën Digjitale të Shqipërisë 2022–2026, miratuar me vendimin nr. 370, datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale 'Agjenda Digjitale e Shqipërisë' dhe të planit të veprimit 2022–2026".
- Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, miratuar me vendimin nr. 173, datë 24.3.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, planit të veprimit për zbatimin e saj, si dhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023–2024";

- Strategjinë Kombëtare për Rininë dhe Plani i Veprimit 2022–2029, miratuar me vendimin nr. 692, datë 26.10.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe planit të veprimit 2022–2029".

- Strategjia Kombëtare e Specializimit Inteligjent (S3) 2025–2030 dhe e planit të veprimit për zbatimin e saj datë 26.12.2024, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 26.12.2024.

Disa nga fushat kryesore të fokusit mbi komponentin digjital në këto dokumente strategjike përfshijnë:

Kategoria	Detajet
Infrastruktura digjitale	- Vendosja e standardeve për pajisjet TIK - Laboratorët inteligjentë *(SmartLabs)* - Përmirësimi i shpejtësisë së internetit dhe mbulimit me Wi-Fi
Zhvillimi i kompetencës digjitale të mësuesve	- Përafrimi me kornizën e BE-së - Përfshirja e kompetencës digjitale në standardet e mësuesit - Trajnimi i vazhdueshëm për stafin mësimor
Literatura digjitale për nxënësit	- Përfshirja e lëndës së TIK-ut në të gjitha klasat e arsimit parauniversitar dhe përditësimi i kësaj kurrikule - Qendrat e teknologjisë jashtë kurrikulës - Zbatimi i mësimit të kombinuar dhe përdorimi i materialeve digjitale

Për të garantuar një drejtim të qartë dhe të qëndrueshëm në zhvillimin e arsimit digjital, Ministria e Arsimit po prezanton planin e veprimit të Agjendës Digjitale për Arsimin. Ky plan synon përshtatjen graduale dhe zbatimin efektiv të teknologjisë në të gjitha nivelet e sistemit arsimor.

Kjo qasje është në përputhje me qëllimet kombëtare, siç përshkruhet në dokumentet strategjike kryesore, si: Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026 dhe Agjenda Digjitale e Shqipërisë (2022–2026), duke e vendosur Shqipërinë në pozicionin e duhur për përmbushjen e standardeve ndërkombëtare dhe për të integruar më tej praktikat digjitale në sistemi arsimor.

Metodologjia

Është zbatuar një metodologji dhe qasje e strukturuar për zhvillimin e këtij plani veprimi, e cila përfshin zhvillimin e kornizës, vlerësimin e situatës aktuale dhe analizën krahasuese me vendet e përzgjedhura.

Si pjesë e **procesit të zhvillimit të kornizës** është ndërmarrë një shqyrtim gjithëpërfshirës i literaturës, duke u mbështetur në burimet kryesore, si: rezolutat dhe rekomandimet për arsimin digjital (Komisioni i BE-së, 2021, 2023), Modelimi i Arsimit Digjital: Faktorët Mundësues për Cilësi, Barazi dhe Eficiencë (OECD 2023) dhe Indeksi i Gatishmërisë së Teknologjisë së Edukimit (Banka Botërore, 2023). Bazuar në gjetjet nga literatura dhe konsultimin me ekspertë, u hartua një kornizë e përshtatur dhe dedikuar për kryerjen e analizës. Korniza (shihni figurën 1) përbëhet nga gjashtë dimensione kyçe: infrastruktura, qeverisja, politikat dhe programet, burimet njerëzore, pedagogjia dhe pjesëmarrja në ekosistem.



Figura 1. *Struktura e personalizuar për analizë*

Për analizën e gjendjes aktuale janë angazhuar të gjithë aktorët kryesorë në Ministrinë e Arsimit dhe strukturat e varësisë së saj, si dhe përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). Janë kërkuar, gjithashtu, pikëpamjet e palëve të interesuara joqeveritare, duke përfshirë Fondin e Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), Fondin Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit (AADF), Bankën Botërore, Fondacionin e Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe Këshillin e Evropës (KiE). Intervistat u strukturuara përmes pyetësorëve të detajuar dhe të hartuar mbi bazën e kornizës së mësipërme. Këto intervista mundësuan njohuri më të thelluara mbi gjendjen aktuale të arsimit digjital. Për më tepër, janë vlerësuar, gjithashtu, mbi 30 dokumente strategjike kombëtare dhe sektoriale për të shqyrtuar iniciativat në implementim dhe ato të planifikuara mbi arsimin digjital.

Analiza krahasuese konsistoi në identifikimin e praktikave më të mira në arsimin digjital në vendet e përzgjedhura, si: Estonia, Singapori, Spanja, Sllovenia dhe Izraeli. Në kuadër të këtij procesi u vlerësuan dokumentet publike që disponoheshin dhe u angazhuam me ekspertë vendës dhe ndërkombëtarë për të mësuar nga përvojat këtyre vendeve. Gjithashtu, u morën në shqyrtim studime dhe raporte ndërkombëtare, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në perspektiva për arsimimin digjital OECD 2023 *(OECD's Digital Education Outlook),* Plani i Veprimit për Arsimin Digjital të BE-së 2021–2027 *EU's Digital Education Action Plan)* dhe analiza e sektorit të arsimit e mbështetur nga UNICEF-i në vitin 2024 *(UNICEF's Education Sector Analysis of Albania).*

Procesi i konsolidimit përfshiu identifikimin e një liste gjithëpërfshirëse politikash, duke nxjerrë përfundime nga standardet ndërkombëtare, strategjitë kombëtare, intervistat e palëve të interesuara dhe sfidat sektoriale. Më pas, u përshtatën këto politika për të siguruar përafrimin me situatën aktuale të arsimit në Shqipëri.

Së fundi, u kategorizuan këto politika në objektiva strategjikë kyç, siç janë: përmirësimi i infrastrukturës digjitale, implementimi i teknologjive inovative dhe promovimi i kurrikulave digjitale gjithëpërfshirëse. Kjo qasje e strukturuar ndihmoi në krijimin e një pakete prej 26 rekomandimesh, të prioritizuara për implementim (afatshkurtër/afatmesëm/afatgjatë), bazuar në faktorë të tillë, si lehtësia e implementimit, kërkesat për burime dhe varësitë ndërmjet tyre.

Kapitulli 1: Situata aktuale

Ky seksion përmban një vlerësim të detajuar të gjendjes aktuale të sistemit arsimor parë kjo nga perspektiva e arsimit digjital.

Qeveria e Shqipërisë ka treguar një angazhim të fortë për integrimin e teknologjive digjitale në të gjithë sektorin e arsimit. Përmes një sërë reformash të koordinuara mirë, vendi ka avancuar në infrastrukturë, korniza politike, mjete digjitale dhe nisma për zhvillimin e mësuesve, me synimin për t'i pajisur si nxënësit, ashtu edhe mësuesit me aftësitë e shekullit XXI.

Përparime të rëndësishme janë bërë në përmirësimin e infrastrukturës digjitale. Të gjitha shkollat në Shqipëri tashmë përfitojnë nga qasja në internet, falë bashkëpunimit midis Ministrisë së Arsimit, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Mbështetja teknike për shkollat sigurohet përmes mësuesve të TIK-ut, zyrave arsimore vendore dhe kanaleve të komunikimit, si: *email,* telefon dhe portali SMIP. Njëkohësisht, nisma, si *SmartLabs* kanë ndihmuar në përmirësimin e raportit pajisje/nxënës, me përmirësime të vazhdueshme dhe mirëmbajtje të koordinuar nga AKSHI dhe Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar. Në arsimin e lartë, investimet në infrastrukturën digjitale mbështeten nga Agjencia Kombëtare për Financimin e Arsimit të Lartë (AKFAL) dhe Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin (AKKSHI), të cilat ofrojnë grante për projekte dhe laboratorë digjitalë të veçantë.

Përdorimi i sistemeve moderne të informacionit ka transformuar mënyrën se si menaxhohen dhe përdoren të dhënat në arsim. Në nivelin parauniversitar, Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP), krijuar me vendimin nr. 742, datë 3.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit të menaxhimit të informacionit parauniversitar (SMIP), u mundëson shkollave të digjitalizojnë të dhëna, si frekuentimi dhe notat, duke mundësuar raportim dinamik dhe planifikim të bazuar në të dhëna. Një platformë e ngjashme, SMIAL, është zhvilluar nga MA-ja dhe AKSHI për të menaxhuar të dhënat e arsimit të lartë, duke zgjeruar më tej infrastrukturën digjitale të sistemit

arsimor. Përveç sistemeve të të dhënave, mjete digjitale, si SMIP-i, ofrojnë ndërveprim në kohë reale midis nxënësve, mësuesve dhe prindërve, ndërsa Qendra Ndërinstitucionale e Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH) u siguron institucioneve të arsimit të lartë dhe shkollave akses në sisteme si *U-Albania,* U-GO dhe PITAGORA, së bashku me një platformë trajnimi *online* për mësuesit.

Nga pikëpamja e qeverisjes, arsimi digjital është i integruar në kuadrin më të gjerë strategjik të Shqipërisë. Iniciativa të qeverisë, si pajisja e shkollave me *SmartLabs*, futja e kodimit që në klasën e parë dhe Programi Kombëtar për Zhvillimin Profesional të Mësuesve pasqyrojnë një vizion të qartë për ndërtimin e kompetencave digjitale, që nga arsimi i fillor deri në arsimin e lartë. Gjithashtu reformat digjitale në arsim në Shqipëri mbështeten nga disa strategji kombëtare – përfshirë Strategjinë Kombëtare të Arsimit (2021–2026), Agjendën Digjitale (2022–2026) dhe Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin (2023–2030).

Në aspektin e zbatimit të politikave, Ministria e Arsimit dhe institucionet në varësi të saj kanë zhvilluar standarde dhe udhëzime të detajuara për të mbështetur zhvillimin e kompetencave digjitale të mësuesve dhe nxënësve, veçanërisht në sistemin parauniversitar. Kurrikula e re e TIK-ut për klasat I–III, e zhvilluar nga ASCAP-i, në bashkëpunim me një grup ndërinstitucional dhe ekspertizë të huaj, siguron koherencë në mësimdhënien digjitale, ndërsa Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë udhëzon zhvillimin e infrastrukturës së TIK-ut në institucionet e arsimit të lartë. MA-ja është duke zbatuar në mënyrë aktive një portofol programesh që mbështesin këto politika. Veçanërisht, programi *SmartLabs* po pajis shkollat me mjete digjitale moderne, duke mbështetur zhvillimin e kurrikulës së re të TIK-ut dhe aftësive të kodimit, që nga klasat e para të arsimit bazë. Ky program mbështetet nga Fondi Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) dhe Banka Botërore. Ndërkohë, Programi Kombëtar për Zhvillimin Profesional të Mësuesve, i nisur në vitin 2024, ofron trajnime për rreth 16,000 mësues, në fusha si qasja STEM, aftësitë digjitale, standardet ndërkombëtare (PISA, TALIS) dhe praktikat gjithëpërfshirëse.

Integrimi i sistemeve të informacionit si SMIP dhe SMIAL forcon më tej ofrimin e arsimit digjital. SMIP-i lehtëson planifikimin e mësimeve, ndjekjen e rezultateve dhe përmirëson komunikimin ndërmjet shkollave dhe prindërve, ndërsa SMIAL ndihmon në menaxhimin e numrit të regjistrimeve të studentëve në të gjitha institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë.

Po ashtu sistemi *e-Matura* është tashmë një komponent kyç i digjitalizimit të procesit të Maturës Shtetërore në Shqipëri. Ai mbulon të gjithë ciklin e administrimit të provimeve, duke përfshirë: aplikimin e kandidatëve përmes portalit *e-Albania;* konfirmimin e aplikimeve nga shkollat; ndarjen në qendra provimi; krijimin e listave dhe raporteve të materialeve; menaxhimin e sekretimit dhe pikëve të provimeve; përllogaritjen e notave; gjenerimin e diplomës; si dhe dërgimin e të dhënave përkatëse në sistemet shtetërore, si SMIP. Gjithashtu, ofron shërbimet *online* për aplikimin dhe administrimin e kërkesave për kopje testi.

Gjithëpërfshirja është, gjithashtu, një përparësi kyçe më sistemin arsimor. Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026 parashikon përdorimin e mjeteve digjitale për të mbështetur fëmijët me aftësi të kufizuara, përfshirë teknologjitë ndihmëse për sfida vizuale, dëgjimore dhe të të nxënit. Këto përpjekje plotësohen nga partneritete ndërinstitucionale, që sjellin ekspertizë teknike dhe financim, si dhe nga organizata dhe donatorë ndërkombëtarë.

Financiarisht, qeveria ka ndarë burime të konsiderueshme për të avancuar arsimin digjital. Monitorimi i këtyre investimeve dhe nismave përkatëse kryhet nga Drejtoria e Statistikave, Jetësimit të Prioriteve dhe Projekteve, e cila, gjithashtu, mbikëqyr raportimin mbi strategjinë kombëtare në përgjithësi përmes vlerësimeve periodike të rregullta.

Ndërtimi i kapitalit njerëzor mbetet një shtyllë qendrore e transformimit të arsimit digjital në Shqipëri. MA-ja dhe institucionet e saj të varësisë luajnë role kyçe në rekrutimin, certifikimin, trajnimin dhe vlerësimin e performancës së mësuesve. Institucionet, si Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe ASCAP-i kanë zhvilluar standarde gjithëpërfshirëse për integrimin e TIK-ut në procesin mësimor, mbështetur nga trajnime përkatëse, ndërsa AKSHI dhe ZVAP-të ofrojnë mbështetje teknike. Programi Kombëtar për Zhvillimin e Mësuesve 2024 përfshin module të fokusuara në kodim, aftësi digjitale dhe metodologji të mësimdhënies dhe aktualisht mbështet rreth 1,340 mësues të TIK-ut dhe të arsimit fillor me programe trajnimi të përshtatura

për përmirësimin e aftësive digjitale të nxënësve në shkollat e pajisura me *SmartLabs*.

Ndërkohë kurrikula e re e lëndës së TIK-ut është duke u implementuar për klasat I–III dhe njëkohësisht është duke u punuar për rishikimin dhe përditësimin e të gjitha programeve mësimore të TIK-ut deri në klasën XII. Në zbatim të kurrikulës së re të TIK-ut për klasat I–III, platforma SMIP, gjithshtu, u mundëson mësuesve dhe nxënësve aksesimin direkt të platfomës së kodimit *CodeMonkey*. Gjatë pandemisë COVID-19 u zhvilluan platforma dhe kanale, si Akademi.al dhe RTSH Shkolla, për të ofruar mësim të bazuar në video, të cilat vazhdojnë të jenë aktive, duke shërbyer si arkiva të pasura të mësimit digjital, të aksesueshme nga të gjithë.

Së fundmi, pjesëmarrja më e gjerë inkurajohet përmes angazhimit në kohë reale të prindërve të mundësuar nga SMIP-i, si dhe përmes partneriteteve efektive publike-private dhe me donatorë. Bashkëpunimet me Vodafone, Akademi.al, AADF dhe UNICEF kanë luajtur një rol kyç në mbështetjen e reformave digjitale të qeverisë, veçanërisht në arsimin parauniversitar.

Në mënyrë të përmbledhur, Shqipëria ka ndërtuar një bazë të fortë për arsimin digjital në të gjithë sistemin e saj arsimor. Përmes infrastrukturës së integruar, planifikimit strategjik, bashkëpunimit ndërsektorial dhe programeve të dedikuara për trajnimin e mësuesve, qeveria vazhdon ta pozicionojë arsimin digjital si një përparësi kombëtare për një mësim gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt së ardhmes.

Kapitulli 2: Vizioni, politikat dhe objektivat e politikave

A. Vizioni

Në krijimin e vizionit për planin e veprimit të agjendës digjitale për arsimin në Shqipëri, u analizuan prioritetet kombëtare, u vlerësua gjendja aktuale e sistemit arsimor dhe u krahasuan me praktikat më të mira globale. Ky proces përfshiu një rishikim të strategjive kryesore kombëtare, të tilla si: Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026 dhe Agjenda Digjitale e Shqipërisë dhe u angazhuan palët e interesuara për të identifikuar aspiratat arsimore të Shqipërisë. Për më tepër, njohuritë ndërkombëtare të përftuara nga analiza e vendeve, si: Finlanda, Singapori dhe Estonia, ndihmuan në evidentimin e temave thelbësore që duhet të orientojnë qasjen e Shqipërisë – më specifikisht inovacioni, gjithëpërfshirja, iniciativat me vizion të qartë, angazhimi global, fokusi në cilësi dhe integrimi digjital.

Bazuar në këto tema, më poshtë evidentohet deklarata e vizionit:

Duke synuar ndërtimin e një shoqërie të fuqizuar në mënyrë digjitale, Shqipëria angazhohet të transformojë sistemin e saj arsimor deri në vitin 2030, përmes modernizimit të infrastrukturës, përdorimit të teknologjive inovative, zhvillimit të kurrikulave digjitale gjithëpërfshirëse dhe fuqizimit të kapaciteteve profesionale të mësuesve.

Nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm dhe të strukturuar të mësuesve, në përputhje me Kornizën Evropiane të Aftësive Digjitale për Edukatorët (DigCompEdu), çdo mësues do të pajiset me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të integruar me sukses teknologjinë në mësimdhënie dhe për të udhëhequr procesin e të nxënit në mjedise të ndryshme, fizike dhe digjitale.

Ky vizion synon të sigurojë që çdo nxënës dhe student në Shqipëri të ketë akses të barabartë në mundësi cilësore për të nxënë, të zhvillojë kompetencat digjitale dhe të jetë i përgatitur për sfidat dhe mundësitë e një bote digjitale në ndryshim të vazhdueshëm.

B. Politikat dhe objektivat e politikave

Nr.	Objektivat dhe politikat
Objektivi 1: Zgjerimi dhe përmirësimi i infrastrukturës arsimore digjitale	
1	Zgjerim i *SmartLabs* në të gjitha shkollat deri në vitin 2027
2	Blerja e 5,500 laptopëve për mësuesit e gjimnazeve
3	Vazhdimi me zgjerimin e lidhjes me internet *Broadband* dhe Wi-Fi me shpejtësi të lartë në të gjitha shkollat
4	Krijimi i platformës kombëtare për menaxhimin e informacionit kërkimor shkencor (ACRIS)
Objektivi 2: Zhvillimi i standardeve të qeverisjes dhe i monitorimit të arsimit digjital	
5	Krijimi i një mekanizmi për zbatimin dhe mbështetjen e Planit të Veprimit të Agjendës për Arsimin
6	Vendosja e standardeve të niveleve të ndryshme për pajisjet digjitale dhe ndërlidhjen në institucionet e arsimit të lartë
7	Finalizimi i treguesve kombëtarë të arsimit dhe miratimi i një strukture të fortë të administrimit të të dhënave arsimore

Objektivi 3: Mundësimi dhe inkurajimi në implementimin e teknologjive inovative, si IA	
8	Zhvillimi dhe zbatimi i udhëzimeve dhe rasteve praktike për përdorimin e IA Gjeneruese *(Generative AI)*
9	Zhvillimi i një plani për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për kurset e teknologjisë së avancuar në institucionet e arsimit të lartë
10	Përfshirja e edukimit mbi IA në kurrikulën e TIK-ut
Objektivi 4: Rritja dhe mbështetja e aftësive digjitale të mësuesve	
11	Zgjerimi i trajnimeve për TIK-un për të gjithë mësuesit dhe ofrimi i mbështetjes për trajnime bazuar në vlerësime periodike
12	Lidhja e programeve të studimit në fushën e mësuesisë me kompetencat digjitale të kërkuara për mësuesit
13	Përditësimi i mekanizmit *online* të zhvillimit të vazhdueshëm profesional për mësuesit
14	Vazhdim i përmirësimit të gjithëpërfshirjes në arsimin digjital
Objektivi 5: Promovimi i kurrikulave digjitale të përditësuara dhe gjithëpërfshirëse	
15	Vazhdimi i përditësimit të kurrikulës dhe kompetencave të TIK-ut për arsimin parauniversitar
16	Zhvillimi dhe zbatimi i një programi edukimi për higjienën digjitale
17	Përdorimi efektiv të Laboratorëve Inteligjent *(SmartLabs)*
18	Përditësimi i përmbajtjes digjitale në përputhje me kurrikulën e përditësuar
Objektivi 6: Inkurajimi i angazhimit shumëpalësh në edukimin digjital	
19	Krijimi i një udhërrëfyesi për të rritur shikueshmërinë në internet të institucioneve të arsimit të lartë dhe shkollave
20	Bashkëpunimi me Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës për përdorimin e teknologjisë në arsim
21	Organizimi i festivalit të mësimit digjital në Shqipëri
22	Krijimi i mekanizmave për njohjen e krediteve të programeve/kurseve specifike Kurse Masive të Hapura *Online* (MOOCs), sipas kërkesës së tregut

Objektivi 1: Zgjerimi dhe përmirësimi i infrastrukturës arsimore digjitale

1. Zgjerimi i Laboratorëve Inteligjent *(SmartLabs)* në të gjitha shkollat deri në vitin 2027

Kjo masë politike përputhet me përpjekjet e vazhdueshme për zgjerimin e laboratorëve inteligjentë në të gjithë territorin e Shqipërisë. Qeveria Shqiptare, në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), prezantoi Laboratorët Inteligjentë *(SmartLabs)* në 100 shkolla, në kuadër të projektit *ElementIT*. Këta laboratorë ofrojnë akses për nxënësit në teknologjinë më të avancuar digjitale, duke përfshirë laptopë, tabela inteligjente, projektorë, kite robotike etj.

Gjatë vitit 2024–2025, në bashkëpunim me Bankën Botërore, u realizua instalimi i 216 laboratorëve inteligjentë në 200 shkolla, ndërkohë që planifikohet pajisja e edhe 654 laboratorëve të tjerë në 616 shkolla, me mbështetjen e Bashkimit Evropian (Bankës së Zhvillimit të Këshillit të Evropës). Këta laboratorë do të shërbejnë si bazë për zbatimin e kurrikulës së re të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për klasat I, II dhe III, me synimin për ta shtrirë në të gjithë sistemin parauniversitar.

2. Blerja e 5,500 laptopëve për mësuesit e gjimnazeve

Blerja e 5,500 kompjuterëve portativë (laptopë), si pjesë e mbështetjes së qeverisë shqiptare për digjitalizimin e arsimit dhe rritjen e aksesit në teknologji për nxënësit dhe mësuesit në shkollat publike. Kjo ndërhyrje është pjesë e Programit Operacional Shumëvjeçar "Ekonomia dhe Shoqëria Digjitale 2024–2027", e financuar nga IPA III, dhe synon përmirësimin e kushteve të të nxënit, fuqizimin e përdorimit të platformave digjitale arsimore dhe mbylljen e hendekut digjital midis zonave urbane dhe rurale.

Rezultati i planifikuar:

- Krijimi i laboratorëve *SmartLabs* me akses për çdo shkollë;
- Blerja e 5,500 laptopëve për mësuesit e gjimnazeve.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- Përmirësimi i raportit nxënës-për-pajisje;
- Qasje universale në pajisjet TIK.

3. Vazhdimi i zgjerimit të lidhjes me brez të gjerë *(Broadband)* dhe Wi-Fi me shpejtësi të lartë në të gjitha shkollat

Kjo masë synon të vazhdojë zgjerimin e lidhjes me brez të gjerë në shkolla për të mundësuar adaptimin dhe integrimin pa probleme të arsimit dhe mësimit digjital.

Ka iniciativa të vazhdueshme si pjesë e "Planit Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të

Infrastrukturës Digjitale, *Broadband* (2020–2025)" që synojnë të zgjerojnë brezin e gjerë me shpejtësi të lartë (të paktën 30 Mbits) për të gjitha shkollat deri në vitin 2025. Si pjesë e Programit të Rritjes dhe Reformës së BE-së, Qeveria e Shqipërisë është angazhuar të lidhë 95% të shkollave publike me një lidhje interneti me shpejtësi të lartë' deri në vitin 2025.

Rezultati i planifikuar:

- Krijimi i Laboratorëve *Smart* me akses për çdo shkollë dhe, në mënyrë të tërthortë, akses në internet me shpejtësi të lartë.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- Akses në internet me shpejtësi të lartë për të gjitha institucionet arsimore dhe integrim i pandërprerë i mësimit digjital.

Kutia 1. Sistemet e Informacionit mbi Studentët

Mbi 65% e vendeve të OBEZH-së (OECD) përdorin sisteme informacioni mbi studentët, të cilat ofrojnë akses në kohë reale në të dhënat e tyre dhe mjete analitike për palët e interesuara. Këto sisteme shërbejnë për qëllime të ndryshme, të tilla si mbështetje për kërkime dhe raporte, duke mbledhur të dhëna të detajuara për hartimin e politikave. Gjithashtu, ndihmojnë në përmirësimin e e-qeverisjes (elektronike) nëpërmjet proceseve të standardizuara, si: regjistrimi dhe shpërndarja e burimeve, si dhe përmirësimin e mësimit të personalizuar përmes *feedback*-ut të dedikuar për mësuesit dhe nxënësit. Për shembull, **Kanadaja** përdor sistemin OnSIS për regjistrimin dhe mbledhjen e të dhënave socio-ekonomike për të ndihmuar vendimmarrjen në nivel rajonal, ndërsa **Letonia** dhe **Koreja** përdorin sisteme të ngjashme për ndjekjen e performancës dhe pjesëmarrjes. **Estonia** e ka integruar sistemin e saj me shërbimet e e-qeverisjes për të mbështetur mësimin gjatë gjithë jetës, ndërsa **Zelanda e Re** dhe **Uellsi i Ri Jugor** përdorin sistemet e tyre për të mbledhur të dhëna të detajuara mbi vlerësimin, duke mundësuar *feedback* të personalizuar mësimor dhe matje të angazhimit.

4. Krijimi i platformës kombëtare për menaxhimin e informacionit kërkimor shkencor (ACRIS)

Planifikohet ngritja e një platforme kombëtare të centralizuar – **ACRIS *(Albanian Current Research Information System)*** – për menaxhimin gjithëpërfshirës dhe të standardizuar të informacionit kërkimor shkencor në Shqipëri. Sistemi do të shërbejë si bazë e vetme reference për grumbullimin, administrimin dhe analizimin e të dhënave në lidhje me:

1. Institucionet kërkimore;
2. Kërkuesit shkencorë;
3. Projektet e zbatuara;
4. Publikimet shkencore;
5. Patentat;
6. Infrastrukturën kërkimore;
7. Burimet e financimit; dhe
8. Rezultatet e arritura nga kërkimi shkencor.

Platforma ACRIS do të mundësojë integrim me sisteme të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe do të rrisë transparencën, llogaridhënien dhe përdorimin e të dhënave për qëllime analitike dhe vendimmarrëse në fushën e kërkimit dhe inovacionit.

Objektivi 2: Zhvillimi i standardeve të qeverisjes dhe monitorimit të arsimit digjital

5. Krijimi i një mekanizmi të zbatimit të planit të veprimit të agjendës digjitale për arsimin

Ministria e Arsimit fokusohet në edukimin digjital me iniciativa kyçe, si përfshirja e lëndës së TIK-ut që nga klasa e parë, rishikimi i kurrikulave TIK për të gjitha klasat, instalimi i laboratorëve inteligjentë *(SmartLabs)* për shkollat dhe programi i trajnimit të Inteligjencës Artificiale për të rinjtë. Këto nisma janë në bashkëpunim me institucione e tjera (p.sh. AKSHI) dhe palët e interesuara joqeveritare (p.sh. AADF, UNICEF etj.). Megjithëse ekzistojnë grupe pune dhe mekanizma të tjerë në nivele projektesh/ iniciativash, nuk ka një mekanizëm të vetëm për drejtimin, monitorimin dhe mbështetjen e zbatimit të nismave të arsimit digjital.

Kjo masë politike synon të krijojë një mekanizëm të dedikuar për monitorimin e zbatimit efektiv dhe në kohë të planit të veprimit të agjendës digjitale për arsimin. Ky mekanizëm do të drejtojë koordinimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve të arsimit digjital nëpër institucione.

Zbatimi i këtij plani veprimi do të monitorohet nga grupi i punës i ngritur nga ministria përgjegjëse për arsimin. Ky proces do të realizohet përmes takimeve të rishikimit periodik, duke përfshirë vlerësime gjatë periudhës së implementimit. Gjithashtu, do të vijojë mbështetja e Agjencisë së Inovacionit dhe Ekselencës dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, si institucione që luajnë rol të rëndësishëm në integrimin e teknologjisë, bazuar në mirëkuptimin dhe diskutimet e përbashkëta mes palëve.

Rezultat i planifikuar:

- Miratimi i një mekanizmi monitorues që përfshin monitorimin dhe raportimin periodik të zbatimit të planit të veprimit.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- Monitorimi dhe zbatimi në kohë: Siguron që plani i veprimit të agjendës digjitale për arsimin të zbatohet brenda afateve kohore të përcaktuara, duke ruajtur llogaridhënien.

- Koordinim i centralizuar dhe efikas: Lehtëson mbikëqyrjen qendrore të iniciativave të ndryshme të arsimit digjital, duke ndihmuar në përputhjen e politikave me qëllimet strategjike.

Kutia 2. Qeverisja e arsimit digjital

Shtetet miratojnë modele të ndryshme qeverisjeje për arsimin digjital bazuar në strukturat e tyre federale. Në **Itali**, një Menaxher i Tranzicionit Digjital drejton iniciativat e riorganizimit dhe digjitalizimit për institucionet arsimore. **Singapori** ka dy modele: Aftësitë e së Ardhmes *SkillsFuture*, e drejtuar nga një drejtor i përgjithshëm, që fokusohet në mësimin dhe aftësitë për shekullin XXI gjatë gjithë jetës së individit, si dhe një divizion të specializuar brenda Ministrisë së Arsimit që përqendrohet në iniciativat e edukimit digjital. **Franca** ka një departament të dedikuar nën Ministrinë e Arsimit me nëndrejtori për shërbimet digjitale, infrastrukturën dhe transformimin.

6. Vendosja e standardeve të shkallëzuara për pajisjet digjitale dhe ndërlidhjen për institucionet e arsimit të lartë

Për arsimin parauniversitar, Ministria e Arsimit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) ka zhvilluar dhe zbatuar struktura dhe mekanizma për të siguruar disponueshmërinë e pajisjeve digjitale dhe lidhje të fuqishme të internetit me brez të gjerë.

Në lidhje me arsimin e lartë, Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë është një dokument kyç që ofron një listë të kërkesave për Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL), të cilat duhet të akreditohen për të ushtruar veprimtarinë e tyre akademike, sipas kuadrit ligjor në Shqipëri.

Për të rritur më tej efektivitetin e këtyre standardeve, kjo masë rekomandon prezantimin e standardeve të shkallëzuara sipas nivelit. Kjo do të përfshijë standardet minimale që do të jenë të zbatueshme për të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL), për të siguruar që të ketë akses universal në infrastrukturën bazë digjitale. Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL), që ofrojnë kurse (të avancuara) të TIK-ut do t'iu kërkohet të përmbushin standarde të avancuara për të siguruar që kurse të tilla të mbështeten nga infrastruktura digjitale e duhur dhe e përditësuar. Kjo qasje siguron që, të gjithë studentët, të kenë akses të barabartë në mjete dhe infrastrukturë digjitale të cilësisë së lartë, të përshtatura për fushat e tyre të studimit, aftësitë dhe synimet për t'i përmirësuar aftësitë në fushën e këtij plani veprimi.

Standardet do të vendosen pas një konsultimi të gjerë me të gjithë aktorët përkatës, duke përfshirë institucionet e arsimit të lartë.

Rezultatet e tjera të mundshme

- Infrastrukturë e unifikuar digjitale: Qëndrueshmëri në burimet digjitale në të gjitha IAL-të, duke siguruar që studentët në institucione të ndryshme të kenë akses të barabartë në teknologjinë thelbësore. Rritje e përgatitjes ndaj tregut të punës: Studentët mund të përdorin mjetet përkatëse të TIK-ut, që përputhen me standardet e industrisë, duke i përgatitur më mirë për punësim në të ardhmen.

- Mbështetje për platformat e reja: Infrastruktura e duhur do të rrisë më tepër përqafimin e platformave të reja, siç është Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Arsimin e Lartë (SMIAL), duke përmirësuar proceset administrative dhe mësimore.

7. Treguesit kombëtarë të arsimit dhe roli i tyre si pjesë e kuadrit të administrimit të të dhënave

Ministria e Arsimit është e fokusuar në përmirësimin e matjes së rezultateve arsimore. Tregues digjital të tillë si numri i pajisjeve digjitale, shpejtësia e lidhjes dhe performanca e pajisjeve mblidhen sipas nevojës. Por, me futjen e sistemit

SMIP në nivel shkolle, mbledhja dhe raportimi i të dhënave është bërë dinamike dhe efikase.

Strategjia Kombëtare e Arsimit, gjithashtu, parashikon nevojën e zhvillimit të treguesve kombëtarë dhe MA po punon ngushtë me INSTAT-in për të arritur këtë rezultat, në përputhje me kornizat ndërkombëtare të OECD-së, Kombeve të Bashkuara dhe BE etj. Kjo masë rekomandon finalizimin e këtyre treguesve kombëtarë të arsimit dhe miratimin e një kornize për qeverisjen e të dhënave.

Ndërsa digjitalizimi bëhet i pandarë në arsim, një kornizë e strukturuar e qeverisjes së të dhënave është thelbësore për mbledhjen, ruajtjen dhe raportimin e saktë të tyre.

Kjo masë politike përfshin tre hapa kryesorë:

1. Finalizimi i treguesve të arsimit: Përafrimi i treguesve kombëtarë të arsimit në kuadër të këtij plani veprimi me Strategjinë Kombëtare të Arsimit, duke përdorur kornizat ekzistuese si Treguesit e Sistemeve Arsimore të OECD-së, Agjenda 2030 e OKB-së për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Bashkëpunimit Evropian në Arsim dhe Trajnim. Ky hap siguron që të gjithë treguesit të jenë të standardizuar dhe në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.

2. Miratimi i kuadrit të qeverisjes së të dhënave: Zhvillimi i një kornize menaxhimi të të dhënave që përcakton çdo tregues, qartëson përgjegjësitë për mbledhjen e të dhënave, si dhe përcakton metodat e mbledhjes së tyre dhe saktëson udhëzimet mbi frekuencën (shpeshtësinë kohore). Kjo kornizë do të përfshijë hartëzimin e praktikave aktuale dhe përshtatjen e tyre bazuar në praktikat më të mira dhe treguesit e dakordësuar.

3. Sigurimi i përditësimit të paneleve informative: Krijimi ose përditësimi i paneleve informative *(dashboard)* (p.sh., përmes SMIP) për shfaqjen e të gjithë treguesve për palët vendimmarrëse në nivele të ndryshme, nga mësuesit dhe drejtorët deri tek zyrtarët e ministrisë. Paneli do të ofrojë të dhëna të sakta në kohë reale për të mbështetur vendimmarrjen dhe zhvillimin e politikave.

Rezultati i planifikuar:

- Miratimi dhe monitorimi i rregullt i treguesve kombëtarë të arsimit;

- Miratimi i kuadrit së qeverisjes së të dhënave arsimore.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- Përmirësimi i vendimmarrjes bazuar në të dhëna dhe evidenca: Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave mundëson vendimmarrje dhe politika të përshtatura për nevojat aktuale arsimore;

- Zgjerimi i kuptimit të ndikimit të masave politike: Të dhënat e besueshme ndihmojnë në vlerësimin efektiv të ndikimit që kanë ndërhyrjet dhe politikat e implementuara dhe orientojnë përmirësimet e tyre në të ardhmen;

- Raportimi efikas për anketat ndërkombëtare: Indikatorët e standardizuar e bëjnë më të lehtë raportimin e të dhënave tek organizatat ndërkombëtare dhe pjesëmarrjen në vlerësimet globale.

Objektivi 3: Mundësimi dhe inkurajimi në implementimin e teknologjive inovative

8. Zhvillimi dhe zbatimi i udhëzimeve dhe i rasteve praktike për përdorimin e IA-së gjeneruese (GenAI).

Me publikimin e ChatGPT nga OpenAI në 2022[2], përdorimi i Inteligjencës Artificiale (IA) Gjeneruese ka njohur rritje në mënyrë të ndjeshme. Duke qenë i orientuar për përdorim të përgjithshëm dhe falas, adoptimi i tij në arsim gjithashtu është rritur. Mjetet e IA-së kanë potencial të konsiderueshëm për të pasuruar praktikat arsimore, por ato kërkojnë udhëzime të qarta dhe mbështetje në trajnime për t'u përdorur në mënyrë etike dhe efektive. Ministria e Arsimit është e angazhuar për të avancuar përdorimin e përgjegjshëm të IA në sistemin arsimor.

Kur mjetet e IA përdoren në mënyrë të sigurt dhe etike, mund të mbështesin mësuesit në përpjekjet e tyre mësimore. Kjo masë synon zhvillimin e udhëzimeve shteruese dhe rasteve të përdorimit për të ndihmuar mësuesit që t'i përdorin këto mjete në mënyrë efektive, krijuese dhe me përgjegjësi. Elementet kryesore të udhëzimeve përfshijnë adresimin e kufizimeve dhe pasaktësive algoritmike, ofrimin e rasteve specifike të përdorimit dhe praktikave më të mira, mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe sqarimin e shqetësimeve lidhur me pronësinë intelektuale.

Rezultatet e planifikuara:

- Publikimi i udhëzimeve të IA gjeneruese dhe rasteve përkatëse të përdorimit;

[2] Prezantimi i ChatGPT | OpenAI

- Implementim i udhëzimeve në të gjitha institucionet arsimore.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- Rritja e ndërgjegjësimit dhe aftësisë për IA-në: mësuesit do të kenë një kuptim më të thellë të mundësive, kapaciteteve, kufizimeve dhe konsideratave etike të IA-së, duke nxitur një përdorim më të informuar dhe të përgjegjshëm;

- Rritja e përdorimit të IA në arsim: udhëzime të qarta dhe shembuj praktikë do të inkurajojnë mësuesit/pedagogët të eksplorojnë aplikimet e IA-së në ambientet e tyre, duke e pasuruar përvojën arsimore;

- Udhëzuesit do të garantojnë përdorimin korrekt të platformave dhe integrimin e tyre më *tool*-e të inteligjencës artificiale për të siguruar rrjedhshmëri dhe përdorim efikas të informacionit në të gjithë zinxhirin arsimor.

9. Zhvillimi i një plani për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për programe/ kurse të teknologjisë së avancuar në Institucionet e Arsimit të Lartë

Ka një kërkesë në rritje për sigurinë kibernetike dhe aftësitë e IA në nivel global[3] dhe në Shqipëri[4]. Duke pasur parasysh kërkesën globale dhe ndikimet e mundshme të sigurisë të teknologjive të tilla, është e rëndësishme të zhvillohet ekspertiza lokale në këto fusha.

Ministria e Arsimit është e angazhuar të zhvillojë bashkëpunime ndërkombëtare, si një nga masat për të adresuar këtë boshllëk. Kjo bazohet më tej në objektivin e përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Arsimit për ndërkombëtarizimin e IAL-së (objektivi C6.1), duke inkurajuar bashkëpunime që rrisin cilësinë e arsimit të lartë në Shqipëri.

Kjo masë politike thekson bashkëpunimin ndërkombëtar për të krijuar mundësi për studentët e IAL-së, që të studiojnë teknologji të avancuara, të tilla si IA dhe siguria kibernetike. Nga ndërtimi i bashkëpunimeve me institucionet ndërkombëtare, IAL-të shqiptare mund t'u ofrojnë studentëve një zgjerim të aksesit në njohuritë më të fundit dhe të kontribuojnë në një forcë punëtore të përgatitur për të ardhmen.

Disa nga iniciativat e propozuara përfshijnë:

- *Për studentët:* Krijimi i programeve të shkëmbimit për programe studimi/kurse të fokusuara në IA, si ato të ofruara nga Erasmus dhe projekti LAIA[5], së bashku me bursa të dedikuara. Bashkëpunimet me platformat MOOC (Kurse Masive të Hapura *Online)* për kurse me kredite në IA mund të zgjerojnë më tej mundësitë e studimit për studentët shqiptar.

- *Për trajnerët:* Organizim program vizitash për profesorë dhe ekspertë të IA-së nga universitetet evropiane (p.sh., përmes projektit READ të AADF-së) dhe mundësimi i leksioneve afatshkurtra nga ekspertë të ftuar mbi tema të specializuara.

- *Për institucionet* : Zhvillimi i projekteve kërkimore të përbashkëta në fushën e IA-së dhe kurse të përbashkëta në IA, (p.sh. Master i Shkencave në IA), duke ndërtuar, gjithashtu, kapacitete akademike lokale përmes programeve të shkëmbimit.

Rezultat i planifikuar:

- Krijimi i një kuadri bashkëpunimi ndërkombëtar për programe/kurse të teknologjisë së avancuar dhe vënia në funksion e 2–3 programeve/kurseve të përbashkëta.

Rezultatet e tjera të mundshme

- Ndërtimi i kapaciteteve të fuqisë punëtore: zgjerimi i grupeve të ekspertëve vendës të trajnuar në IA dhe në sigurinë kibernetike.

- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë: forcimi i lidhjeve midis IAL-së shqiptare dhe evropiane, duke hapur rrugën për bashkëpunime të vazhdueshme.

- Akses në njohuri të avancuara: u ofron studentëve dhe stafit akademik akses më të madh në kërkime, teknologji dhe ekspertiza bashkëkohore, duke nxitur inovacionin dhe kërkimet në fushat kryesore të teknologjisë.

10. Përfshirja e Inteligjencës Artificiale në kurrikulën e TIK-ut në arsimin parauniversitar

Me rritjen e përdorimit të IA-së në jetën tonë të përditshme, edukimi rreth IA po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Konsensusi global i shprehur në dokumentin e UNESCO-s[6], "Konsensusi i Pekinit për IA-në dhe Arsimin" mbështet integrimin e IA në kurrikulat shkollore.

Kjo masë synon të zhvillojë dhe integrojë Inteligjencën Artificiale (IA) në arsimin

[3] https://www.weforum.org/stories/2024/07/why-closing-the-cyber-skills-gap-requires-a-collaborative-approach/

[4] PwC: Emigrimi i të rinjve po kërcënon sigurinë kibernetike të Shqipërisë - Telegrafi - Telegrafi

[5] LAIA_Project-Announcement_në_Anglisht.pdf

[6] Konsensusi i Pekinit për Inteligjencën Artificiale dhe Edukimin - Biblioteka Digjitale e UNESCO-s

parauniversitar, duke e përfshirë brenda edhe në kurrikulën ekzistuese të TIK-ut, veçanërisht për nxënësit nga klasa IV deri në klasat më të larta.

Zbatimi i këtij rekomandimi përfshin tri faza:

- *Zhvillimi:* Përfshirja në mënyrë aktive e mësuesve dhe e ekspertëve të IA-së në procesin e hartimit të kurrikulës, për të siguruar që përmbajtja të përputhet me nevojat arsimore dhe të adresojë sfidat praktike.

- *Integrimi:* Trajnimi i mësuesve për të ofruar konceptet e IA-së në mënyrë efektive. Duhet marrë parasysh që temat dhe konceptet e inteligjencës artificiale mund të përfshihet jo vetëm në programet e trajnimit por edhe në edukimin fillestar të mësuesve.

- *Zbatimi:* Pilotimi i kurrikulës në shkollat me arritje të larta në të nxënë dhe ato me infrastrukturë të përshtatshme, si shkollat me *SmartLabs*, përpara se të shtrihet edhe në shkolla të tjera.

Rezultati i planifikuar:

- Edukimi i IA-së integrohet në kuadrin kombëtar të kurrikulës për arsimin parauniversitar.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- *Përmirësim i njohurive në IA:* nxënësit përvetësojnë njohuri bazë dhe të aplikueshme mbi IA-në, duke u përgatitur më mirë për arsimin e mëtejshëm dhe tregun e punës, specifikisht në fushën e teknologjisë .

- *Ekspertiza e mësuesve në edukimin e IA:* mësuesit zhvillojnë aftësi të specializuara për mësimdhënien e IA-së, në mënyrë që të udhëheqin nxënësit në mënyrë efektive për përdorimin e IA.

- *Modeli për zgjerim në shkolla të tjera*: përvoja e shkollave pilote krijon një model të suksesshëm dhe shërben si një bazë për zgjerimin e edukimit mbi IA-në edhe në shkolla të tjera në sistemin e arsimit parauniversitar.

Kutia 3. IA në arsim

Ndërsa IA bëhet gjithnjë e më e rëndësishme në arsim, disa vende kanë filluar ta integrojnë atë në kurrikulat e tyre të TIK-ut ose në lëndë të ndryshme. Qasjet e integrimit janë të ndryshme, duke përfshirë kurrikula të veçanta për IA-në si lëndë të pavarura, kurrikulat ndërdisiplinore që kombinojnë IA-në me mësimin e bazuar në projekte, kurrikula fleksibël, që shkollat i përshtatin në nivel lokal dhe kurrikula të integruara, që përfshijnë IA në lëndët ekzistuese, si TIK dhe matematika. Për shembull, Kina mbulon IA nga klasat I deri në XII brenda shkencës së informacionit, ndërsa edukimi mbi IA-në në Indi është i përfshirë në laboratorët STEM për klasat VI–XII. Republika e Koresë përfshin IA-në në matematikë dhe në ekonomi shtëpiake për klasat IX–XII, ndërsa Gjermania lejon që rajonet të vendosin për integrimin e kurrikulës së IA-së në klasat I–XII. Këto modele të ndryshme nxjerrin në pah tendencën globale të përfshirjes së IA-së në sistemet arsimore për të përgatitur nxënësit për të ardhmen.

Objektivi 4: Rritja dhe mbështetja e aftësive digjitale të mësuesve

11. Zgjerimi i trajnimeve në TIK për të gjithë mësuesit dhe ofrimi i mbështetjes për trajnime bazuar në vlerësime periodike

I nisur nga Ministria e Arsimit në vitin 2023, Programi Kombëtar i Zhvillimit Profesional të Mësuesve synon zhvillimin holistik të mësuesve. Një aspekt kyç i programit përfshin ofrimin e trajnimit për rreth 1340 mësues të arsimit fillor dhe TIK për përmirësimin e aftësive digjitale të nxënësve në shkollat e pajisura me SmartLab. Gjithashtu, për më tepër, si pjesë e trajnimit të detyruar për të paktën 3 ditë në vit, mësuesit mund të zgjedhin trajnime të ndryshme në fushën e TIK-ut bazuar në nevojat e tyre për zhvillim të vazhdueshëm profesional.

Duke marrë parasysh rritjen e vazhdueshme të përdorimit të teknologjive digjitale në jetën e përditshme dhe në procesin mësimor, është e domosdoshme që të gjithë mësuesit të zotërojnë një nivel minimal të aftësive bazë digjitale. Kjo masë rekomandon trajnimin e detyrueshëm për të gjithë mësuesit në fushën e aftësive bazë në TIK, si dhe në përdorimin efektiv të teknologjisë në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies. Gjithashtu, ajo parashikon rishikime periodike të kompetencave digjitale të mësuesve, me qëllim ofrimin e mbështetjes dhe mundësive të personalzimit të trajnimit bazuar në nivelin e aftësive digjitale të tyre. Ky trajnim do të realizohet në përputhje me "Standardet Profesionale për Mësuesit mbi përdorimin e TIK-ut" (ASCAP dhe UNESCO, 2020).

Veprimet e propozuara përfshijnë:

- *Trajnim i detyrueshëm për aftësitë bazë të TIK-ut:* zhvillimi dhe kërkesa për një program trajnimi të aftësive bazë digjitale, në përputhje me standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK-ut, hartuar nga ASCAP-i.

- *Përdorim i mjetit SELFIE të BE-së:* ofrimi i aksesit për mësuesit në përdorimin e SELFIE-s, një mjet vetëreflektimi që ndihmon në vlerësimin e kompetencës digjitale dhe identifikimin e fushave për përmirësim.

- *Hartëzimi i nevojave për trajnime*: identifikimi i mangësive në aftësitë digjitale bazuar në vlerësimin e kompetencave, si dhe mbështetja e mësuesve me programe të përshtatura për zhvillimin e mëtejshëm të aftësive dhe metodave të mësimdhënies digjitale.

Rezultati i planifikuar:

- Miratimi i një programi trajnimi për aftësitë bazë digjitale për të gjithë mësuesit.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- *Nivele të unifikuara të aftësive digjitale:* vendosja e një niveli minimal të aftësive bazë të digjitale për të gjithë mësuesit, duke kontribuar në një qasje më të koordinuar dhe të qëndrueshme ndaj arsimit digjital.

- *Adoptimi i përshpejtuar i mjeteve digjitale:* rritja e aftësisë së mësuesve për të integruar mjetet dhe burimet digjitale në procesin mësimor, duke sjellë përfitime të drejtpërdrejta për nxënësit;

- *Rrugëtime të trajnimit të personalizuar:* mundësimi i përmirësimit të synuar të aftësive përmes rishikimeve periodike të kompetencave digjitale, duke i udhëzuar mësuesit drejt aktiviteteve të përshtatshme të zhvillimit profesional.

12. Lidhja e programeve të studimit në fushën e mësuesisë me kompetencat digjitale për mësuesit

Ministria e Arsimit është duke punuar vazhdimisht për të adoptuar TIK-un dhe kodimin në kurrikula dhe të ofrojë trajnime të nevojshme për mësuesit. Me rritjen e përdorimit të mjeteve dhe metodave digjitale, mësuesit e rinj pritet të jenë të përditësuar mbi teknologjinë digjitale. Prandaj, ekziston nevoja për të përditësuar programet e edukimit bazë të mësuesve të rinj, me qëllim për t'i përgatitur ata me aftësitë e nevojshme në mbështetje të mësimit digjital.

Kjo masë rekomandon përafrimin e programeve të studimit në fushën e mësuesisë me kompetencat digjitale. Përfshirja e kompetencave digjitale brenda kurrikulave të formimit bazë në arsim, siguron që mësuesit e rinj të jenë të aftë për të integruar në mënyrë efektive teknologjinë në praktikat e tyre të mësimdhënies që nga fillimi i karrierës së tyre.

Institucionet arsimit të lartë ofrojnë programe studimi në fushën e mësuesisë, të cilat mund të përfshijnë:

1. Lëndë të pedagogjisë digjitale: lëndë të detyrueshme ose me zgjedhje që fokusohen në metodat e mësimdhënies digjitale.

2. Orë mësimore: një numër minimal orësh të dedikuara për trajnim në pedagogjinë digjitale, duke siguruar mbulim të plotë të aftësive të nevojshme.

Rezultati i planifikuar

Pajisja me kompetenca digjitale të mësuesve të rinj.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- *Trajnim digjital i avancuar për mësuesit e rinj:* Siguron që mësuesit e rinj të kenë një nivel bazë të njohurive digjitale, duke u mundësuar atyre të përdorin mjete dhe metoda të mësimdhënies digjitale.

- *Mbështetje nga institucionet e arsimit të lartë:* inkurajon IAL-të që ofrojnë programe në fushën e mësuesisë të ofrojnë mundësi të përshtatshme për të mësuar në mënyrë digjiitale për studentët që ndjekin këto programe, duke e përafruar formimin e tyre me nevojat reale të procesit mësimor.

13. Përditësimi i mekanizmit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional *online* (ZHP) për mësuesit

Ministria e Arsimit është e përkushtuar ndaj zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe përmirësimit të aftësive të mësuesve. Në një botë që po avancon me ritme të shpejta teknologjike, siç dëshmohet edhe me zhvillimin e Inteligjencës Artificiale, është thelbësore që mësuesit të jenë të përgatitur dhe të trajnuar.

Një mekanizëm i fuqishëm dhe i përditësuar i zhvillimit profesional të vazhdueshëm është çelësi për të siguruar që stafi akademik të zotërojë njohuritë e nevojshme dhe të përdorë teknologjitë më të avancuara në mësimdhënie.

Ministria ofron akses në disa aktivitete të zhvillimit të vazhdueshëm profesional nga një mori ofruesish të akreditуar. Këto aktivitete trajnimi janë të aksesueshme nëpërmjet portalit Training4ALL. Gjithashtu, ka iniciativa të tjera që ofrojnë trajnime për mësuesit, si programi CRED4TEACH7 i Bashkimit Evropian dhe programet EU4Inclusive për shkollat dhe ESEP/eTwinning. Megjithatë, ekziston nevoja

[7] *CRED4TEACH - Shqipëri* (n.d.). https://cred4teach.univlora.edu.al/

për të centralizuar të gjitha këto burime për t'i ardhur në ndihmë mësuesve që të kenë lehtësisht akses dhe të regjistrojnë pa probleme përparimin e tyre.

Për më tepër, disa aktivitete ofrohen fizikisht ndërsa disa përmes platformave online. Pra, mund të jetë sfiduese të mbahet një historik i zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve dhe të ofrohet mbështetje e personalizuar për trajnimin e tyre.

Kjo masë synon të përmirësojë portalet ekzistuese të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve, me qëllim për t'u siguruar mësuesve akses të centralizuar në të gjitha burimet dhe për të mundësuar krijimin e një regjistri digjital të aktiviteteve të tyre në procesin e zhvillimit të vazhdueshëm. Elementet kryesore përfshijnë:

- Biblioteka e burimeve *të hapura arsimore:* një koleksion mjetesh digjitale, video, dhe burime të tjera për të mbështetur mësuesit në mësimin e tyre të vazhdueshëm dhe zhvillimin e aftësive digjitale.

- *Portofola digjitalë:* një historik të rrugëtimit të zhvillimit profesional të secilit mësues, duke përdorur IA për të mbështetur përparimin në nivel afatgjatë.

- *Qasja te kurset/aktivitetet online:* Bashkëpunim me ofruesit e trajnimeve, organizatat ndërkombëtare dhe sektorin privat për të ofruar një gamë të gjerë aktiviteteve për rritjen profesionale.

Rezultati i planifikuar:

- Mekanizmi i përmirësuar i zhvillimit të vazhdueshëm profesional me bibliotekë të centralizuar të burimeve të trajnimit, trajnime *online* dhe portofol digjital të mësuesve me linja të personalizuara të të mësuarit.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- *Qasje më e madhe në aktivitetet e zhvillimit profesional:* U ofron mësuesve një përzgjedhje të larmishme kursesh *online* dhe *offline*, duke mbështetur zhvillimin profesional afatshkurtër dhe afatgjatë.

- *Regjistra të centralizuara të zhvillimit profesional:* Një pikë e vetme aksesi për ndjekjen e aktiviteteve të zhvillimit profesional që mundëson plane mësimore dhe aftësimi të personalizuara.

Kutia 4. Portale për trajnimin e mësuesve[8]

Disa vende të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) kanë zhvilluar portale në internet *(online)* për të mbështetur mësimin e personalizuar për mësuesit, duke ofruar burime të përshtatura për nevojat e arsimit digjital. Për shembull, Réseau CANOPÉ në Francë ofron mjete të tilla, si trajnim në detyrë *(Canotech),* një bankë të praktikave më të mira dhe aktivitete digjitale ndërvepruese, duke i ndihmuar mësuesit të integrojnë teknologjinë në klasat e tyre. DIGISNAP në Belgjikë, i bazuar në mjetin SELFIE për MËSUESIT, u lejon mësuesve të vlerësojnë aftësitë e tyre digjitale dhe të krijojnë plane zhvillimi të personalizuara.

14. Vazhdimi i përmirësimit të gjithë-përfshirjes në arsimin digjital

Për fëmijët me aftësi të kufizuara nevojiten strategji të dedikuara për të plotësuar nevojat e tyre të ndryshme të të nxënit. Qeveria e Shqipërisë ka ndërmarrë disa hapa për të plotësuar mbështetjen dhe integrimin e nxënësve me AK-në në shkolla, duke përfshirë Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara. Ministria e Arsimit po bashkëpunon me partnerë si Fondacioni i Shoqërisë së Hapur të Shqipërisë për të ofruar trajnime të arsimit gjithëpërfshirës për mësuesit dhe për të siguruar gjithëpërfshirjen në kornizën e re të bazuar në kompetenca.

Kjo masë fokusohet në integrimin e teknologjisë mbështetëse, përshtatjen me standardet ndërkombëtare të aksesit në web dhe platforma *online,* si dhe zgjerimin e trajnimeve për mësuesit për të përmirësuar gjithëpërfshirjen në arsim. Veprimet kryesore përfshijnë:

- *Teknologji ndihmëse ose mbështetëse në klasa:* kryerja e vlerësimeve të nevojave për teknologji mbështetëse, duke ndjekur kornizën e UNICEF-it[9] dhe përshtatja me Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara për të siguruar që teknologjia mbështetëse të përdoret në mënyrë efektive dhe të përshtatshme brenda kuadrit ligjor në fuqi. Në kuadrin e mbështetjes së programit IPA II, jo vetëm janë përmirësuar infrastrukturat fizike të dy

[8] OECD (2023), *OECD Perspektiva e Arsimit Digjital 2023: Drejt një Ekosistemi Efektiv të Arsimit Digjital* , Botim i OECD-së, Paris, https://doi.org/10.1787/c74f03de-en.

[9] Forcimi i ekosistemit kombëtar për ofrimin dhe përdorimin e teknologjisë ndihmëse/komunikim shtesë dhe alternativ për fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët me aftësi të kufizuara në Armeni (UNICEF).

qendrave burimore për fëmijët me aftësi ndryshe, që nuk dëgjojnë e nuk shikojnë, por po përgatitet platforma digjitale për nxënësit që nuk shikojnë, që përfaqëson përdorimin konkret të teknologjive ndihmëse për këta nxënës.

- *Aksesi në web dhe në platforma mësimore online:* Përshtatja e *platforma mësimore online* me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të aksesesueshmërisë, të tilla si udhëzimet e BE-së[10] për përfshirjen. Gjithashtu, mund të eksplorohet përdorimi i zgjidhjeve të mundësuara përmes IA-së për të përmirësuar aksesin në web. Platforma web e dedikuar zhvillimit profesional të mësuesve është në proces. Kjo platformë do të mundësojë trajnimin dhe vetëtrajnimin *online* të mësuesve, si dhe do të përfshijë në funksionalitetet e veta edhe mjete mësimore TIK të dedikuara për mësuesit drejt përmirësimit të të nxënit dhe cilësisë së mësimdhënies. Kjo platforme web dhe mobile do të krijohet në kuadrin e implementimit të projektit EU4Teaching, në kuadrin e mbështetjes së programit IPA II.

- *Trajnimi i mësuesve për gjithëpërfshirjen:* zgjerimi i programeve të trajnimit për të mbuluar strategjitë e arsimit gjithëpërfshirës, duke përfshirë opsionet e trajnimeve fizike dhe në internet *(online)*. Këto trajnime janë të fokusuara në pedagogjinë gjithëpërfshirëse. Aktualisht janë trajnuar 1830 mësues me fokus gjithëpërfshirjen dhe do të trajnohen gjithsej 15000 mësues të arsimit parauniversitar në kuadrin e mbështetjes së programit IPA II.

Rezultati i planifikuar:

- Një vlerësim i nevojave për teknologjisë mbështetëse *(Assistive Technology)* në shkolla dhe për programe gjithëpërfshirëse të trajnimit të mësuesve.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- *Zgjerimi i akses i të nxënit:* Më shumë nxënës mund të kenë akses në përvojat e të nxënit digjital, duke e përshtatur këtë të fundit sipas nevojave të tyre.

- *Përputhshmëria me praktikat ndërkombëtare:* Platformat mësimore *online* plotësojnë standardet ndërkombëtare të aksesueshmërisë, duke rritur përafrimin me praktikat globale.

Objektivi 5: Promovimi i kurrikulave digjitale të përditësuara dhe gjithëpërfshirëse

15. Vazhdimi i përditësimit të kurrikulës dhe i kompetencave të TIK-ut për arsimin parauniversitar

Programi i TIK-ut për klasën e parë, të dytë dhe të tretë është hartuar mbi bazën e krijimit të njohurive dhe aftësive digjitale të nxënësve që në moshë të hershme, duke respektuar kuadrin moshor dhe nivelin fillestar të njohurive që këta nxënës zotërojnë. Këto programe mësimore janë hartuar në bashkëpunim me specialistë të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), specialistë të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), përfaqësues të kabinetit të Ministrisë së Shtetit për Fëmijët dhe Rininë, si dhe në bashkëpunim me ekspertin britanik të mundësuar nga AADF-ja.

Kurrikula e re e TIK-ut për klasat I–III prezanton konceptet bazë të TIK-ut duke përfshirë tematika përmbajtjesore, si: bota e kompjuterit, hyrja në multimedia, të menduarit kompjuterik dhe kodimi, si dhe siguria e të punuarit në kompjuter. Platforma "CodeMonkey" është prezantuar, gjithashtu, për të lejuar prezantimin e hershëm me kodimin.

Kjo masë parashikon përditësimin e vazhdueshëm të kurrikulës së TIK-ut dhe kompetencave në arsimin parauniversitar. Me përditësimet tashmë të zbatuara për klasat I deri në III. Kjo kurrikul do të vazhdojë të zhvillohet dhe të përditësohet në të gjitha klasat e tjera të arsimit parauniversitar, në përputhje me përmbajtjen e kurrikulës së re të hartuar për lëndën e TIK-ut.

Rezultati i planifikuar

- Kurrikula dhe kompetencat e TIK-ut të përditësohen për të gjitha klasat në arsimin parauniversitar.

Rezultatet e tjera të mundshme

- Nxënësit kanë akses në kurrikulën më të fundit të TIK-ut dhe zhvillojnë aftësi të epokës së re.

16. Zhvillimi dhe zbatimi i një programi edukimi për higjienën digjitale

Me rritjen e përdorimit të mjeteve digjitale dhe internetit, nxënësit janë më të ekspozuar ndaj rreziqeve dhe dëmeve digjitale. Ekziston një numër i madh i mashtrimeve dhe i fushatave keqinformuese në internet. Qeveria e Shqipërisë ka ndërmarrë hapa proaktivë për të mbështetur

[10] Standardizimi i aksesueshmërisë – Punësimi, Çështjet Sociale dhe Përfshirja – Komisioni Evropian.

popullatën që të përgatitet më mirë kundër këtyre rreziqeve dhe dëmeve. Këtu përfshihen seminare për sigurinë në internet të drejtuara nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike AKSK në shkollat në Shqipëri me mbështetjen e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve. Ministria e Arsimit po bashkëpunon me partnerë, si Këshilli i Evropës për ndërgjegjësimin mbi bullizmin kibernetik, edukimin mediatik, sigurinë në internet si pjesë e[11] projektit "Forcimi i Edukimit për Qytetarinë Demokratike në Shqipëri".

Përmes këtij dokumenti strategjik, Shqipëria afirmon angazhimin e saj për të ndërtuar **shkolla të sigurta, jo vetëm fizikisht, por edhe në hapësirën digjitale**, në përputhje me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve.

Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri (CRCA) raporton se 60% e fëmijëve përballen me bullizëm kibernetik [12], duke nënvizuar nevojën urgjente për marrjen e masave për mbrojtjen e fëmijëve. Kjo masë rekomandon zhvillimin dhe miratimin e një programi gjithëpërfshirës të higjienës digjitale. Kjo përfshin burime në internet dhe trajnime të rregullta për nxënësit, mësuesit dhe prindërit mbi tema si sjellja e sigurt në internet, siguria e të dhënave dhe njohuritë mbi median sociale.

Në dhjetor 2024, Ministria e Arsimit publikoi "Planin kombëtar të veprimit për fuqizimin e mekanizmave të parandalimit të çdo forme dhune e bullizmi, për sigurinë në institucionet arsimore parauniversitare ofron një qasje gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe trajtimin e çdo forme dhune dhe bullizmi në shkolla". Ky plan synon forcimin e politikave dhe mekanizmave për parandalimin dhe trajtimin e çdo forme dhune dhe bullizmi, përfshirë dhunën fizike, psikologjike dhe bullizmin kibernetik. Një ndër shtyllat kryesore të këtij plani është siguria në mjediset digjitale, duke adresuar rreziqet në rritje, që lidhen me përdorimin e teknologjisë dhe rrjeteve sociale nga fëmijët dhe të rinjtë.

Në këtë kuadër, plani parashikon masa konkrete për edukimin digjital të nxënësve për sjellje të sigurta *online,* forcimin e kapaciteteve të mësuesve dhe të prindërve për të njohur dhe parandaluar rreziqet kibernetike, ngritjen e strukturave mbështetëse për raportimin dhe ndjekjen e rasteve të bullizmit *online,* përfshirjen e sigurisë kibernetike në programet edukative dhe aktivitetet e shkollave.

Aktivitete të tjera kyçe përfshijnë integrimin e moduleve të higjienës digjitale në kurrikulën kombëtare, zgjerimin e trajnimeve të higjienës digjitale për mësuesit e tjerë jo vetëm të TIK-ut, ofrimin e një kursi të higjienës digjitale për prindërit nëpërmjet SMIP-it dhe kryerjen e fushatave të rregullta ndërgjegjësuese mbi bullizmin kibernetik dhe sigurinë në internet. Tema të rëndësishme mbulojnë ndërgjegjësimin (qytetetaria digjitale, shkrim-leximin mediatik, ngacmimi kibernetik) dhe sigurinë personale (menaxhimi i fjalëkalimeve, praktikat e shfletimit të sigurt, siguria e mediave sociale).

Rezultat i planifikuar:

- Hartimi dhe implementimi në të gjitha shkollat i një programi edukimi mbi higjienën digjitale.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- *Rritja e ndërgjegjësimit:* nxënësit, mësuesit dhe prindërit do të fitojnë aftësi thelbësore për të lundruar në hapësirat digjitale në mënyrë të sigurt.

- *Reduktimi i ngacmimeve kibernetike dhe mashtrimeve:* edukimi proaktiv mbi kërcënimet digjitale do të reduktojë incidentet e ngacmimeve kibernetike, shkeljet e të dhënave dhe mashtrimet në internet.

- *Forcim i palëve të interesuara:* mësuesit dhe prindërit do të jenë më të aftë për të mbështetur mirëqenien digjitale të nxënësve.

Kutia 5. Siguria e fëmijëve në internet

Garantimi i sigurisë së fëmijëve në internet kërkon një përpjekje bashkëpunuese në të gjithë komunitetin e shkollës, me vende si Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Gjermania që ndjekin një qasje unike. Në Mbretërinë e Bashkuar, siguria në internet është pjesë e kurrikulës shkollore, me Projektligjin e Sigurisë *Online* 2023[13] që përforcon masat mbrojtëse. Franca integron sigurinë në internet në kurrikulën e saj dhe detyron trajnimin e mësuesve, duke theksuar, gjithashtu, ndërgjegjësimin e prindërve përmes fushatave kombëtare. Qasja e Gjermanisë përfshin një kornizë mbarëkombëtare për edukimin e medias dhe ligje të rrepta për mbrojtjen e të dhënave,

[11] Forcimi i Edukimit për Qytetarinë Demokratike në Shqipëri – Arsimi.

[12] Crca. (2019, 21 qershor). *60% e fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri janë viktima të bullizmit online.* CRCA. https://www.crca.al/en/60-fëmijët-dhe-të rinjtë-në-Shqipëri-janë-viktima-e-bullying-online/

[13] Akti i Sigurisë në internet 2023 – Ligjet parlamentare – Parlamenti i Mbretërisë së Bashkuar.

duke siguruar që shkollat të jenë në përputhje me standardet e forta të privatësisë. Strategjitë e çdo vendi pasqyrojnë një angazhim për krijimin e mjediseve digjitale më të sigurta për nxënësit.

17. Përdorimi efektiv i Laboratorëve Inteligjentë *(SmartLabs)*

Që nga viti 2022, Ministria e Arsimit dhe Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) në bashkëpunim me partnerë si Fondacioni Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit, Banka Botërore prezantoi Laboratorët Inteligjentë *(SmartLabs)* në Shqipëri. Bëhet fjalë për laboratorë të rinj me internet Wi-Fi me shpejtësi të lartë, laptopë, tabela interaktive, projektorë dhe komplete robotike. Aktualisht, 316 laboratorë janë funksionalë dhe përdoren kryesisht për kurrikulën e re të TIK-ut për klasat e para. Më pas mbi 600 laboratorë të tjerë do të jenë operacional në 2025–2026, me mbështetjen e fondeve të Bashkimit Evropian.

Kjo masë propozon mënyra të reja për të maksimizuar përdorimin e këtyre laboratorëve. Kjo mund të sigurojë që këta laboratorë të mbështesin një gamë më të gjerë përvojash mësimore, duke optimizuar vlerën e tyre dhe duke përmirësuar të mësuarit digjital në shkolla. Këto përfshijnë:

- *Për mësuesit:* Hapja e laboratorëve për mësuesit që dëshirojnë të përfshijnë mjete digjitale në mësimet e tyre, duke i lejuar ata të përdorin këto hapësira si për qëllime mësimore ashtu edhe për detyra administrative, si futja e të dhënave SMIP ose trajnime profesionale.

- *Për nxënësit:* Lejimi i klubeve të nxënësve të cilët kanë akses në laboratorë për aktivitete jashtëshkollore, duke përfshirë projektet dhe eksplorimin e burimeve digjitale.

- *Për programet:* Zgjerimi i programeve ekzistuese digjitale, të tilla si iniciativa Intel IA për të Rinjtë në Laboratorët Inteligjentë *(SmartLabs)* dhe inkurajimi i projekteve pilot që integrojnë iniciativat e TIK-ut dhe të të mësuarit digjital në kurrikulën shkollore.

Rezultati i planifikuar:

- Hartimi dhe miratimi i një plani shfrytëzimi për laboratorët inteligjentë *(SmartLabs).*

Rezultatet e tjera të mundshme:

- Përdorimi i optimizuar i Laboratorëve Inteligjent *(SmartLabs):* Rritja e aksesit në laboratorë si për nxënësit ashtu edhe për mësuesit duke shpënë në përvoja arsimore më dinamike dhe të pasura me teknologji.

- Qasje e përmirësuar në infrastrukturën digjitale: Mësuesit dhe nxënësit përfitojnë nga ekspozimi i vazhdueshëm ndaj mjeteve moderne digjitale, duke nxitur aftësimin dhe kompetencën digjitale.

18. Përditësimi i përmbajtjes digjitale në përputhje me kurrikulën e përditësuar

Ministria e Arsimit, me mbështetjen e UNICEF-it dhe partnerëve të saj, ka zhvilluar video në internet *(online)* për të gjitha lëndët e arsimit parauniversitar. Kjo ishte një përgjigje e menjëhershme ndaj COVID-19. Këto burime u implementuan në kohë dhe ishin të dobishme duke mundësuar vazhdimësinë e të mësuarit gjatë pandemisë COVID-19. Sot, ato janë të aksesueshme nga të gjithë nxënësit në çdo kohë përmes platformës SMIP dhe YouTube.

Kjo masë rekomandon përditësimin e të gjithë përmbajtjes mësimore në internet për t'u lidhur me kurrikulën më të fundit dhe për të siguruar përditësime periodike në mënyrë që materialet të jenë të disponueshme në vazhdimësi. Përditësimet e rregullta do të sigurojnë që nxënësit të kenë akses në informacion të përditësuar dhe me cilësi të lartë që i vjen në ndihmë mësimit të tyre dhe pasqyron kurrikulën më të fundit.

Rezultati i planifikuar:

- Zhvillimi dhe përditësimi i përmbajtjes së mësimit në internet në përputhje me kurrikulën më të fundit dhe krijimi i një mekanizmi institucional për përditësime periodike.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- Akses në përmbajtjen e mësimit në internet duke e mundësuar mësimin në distancë në çdo kohë dhe kudo.

Objektivi 6: Inkurajimi i angazhimit shumëpalësh në edukimin digjital

19. Krijimi i një udhërrëfyesi për të rritur vizibilitetin në internet të institucioneve të arsimit të lartë

Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026 thekson rëndësinë e rritjes së shikueshmërisë në internet të institucioneve të arsimit të lartë për të siguruar konkurrencën globale, për të përmirësuar aksesin në informacion dhe për të nxitur kompetencën digjitale. Ndërsa Shqipëria përparon drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, është thelbësore që institucionet e saj arsimore të tërheqin studentë, pedagogë dhe bashkëpunime ndërkombëtare. Prezenca e përmirësuar në internet siguron që studentët, prindërit dhe palët e

interesuara të kenë lehtësisht akses në informacion, në lidhje me programet arsimore, proceset e pranimit dhe arritjet institucionale, duke nxitur besimin dhe angazhimin në sistemin arsimor.

Ky rekomandim kërkon krijimin e një udhërrëfyesi për të rritur shikueshmërinë në internet të institucioneve të arsimit të lartë. Kjo përfshin përmbushjen e objektivave specifikë të Strategjisë Kombëtare të Arsimit.

- C4.1.1 që thekson "zhvillimin e rregulloreve për publikimin e të dhënave dhe dokumenteve përkatëse në faqet e internetit të IAL-ve *(Open Data)".*

Rezultati i planifikuar

- Miratimi dhe zbatimi i një udhërrëfyesi për angazhimin e IAL-ve.

Rezultatet e tjera të mundshme

- Disponim i lehtë i të gjithë informacionit përkatës *online,* në lidhje me Institucionet e Arsimit të Lartë dhe në institucionet e arsimit parauniversitar.

20. Bashkëpunimi me Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës për përdorimin e teknologjisë në arsim

Në nëntor 2023, Qeveria e Shqipërisë themeloi Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës (AIE). Agjencia po mbështet të gjitha ministritë në zgjidhjen e disa prej sfidave më urgjente në mënyra unike dhe inovative.

Kjo masë rekomandon një bashkëpunim me Agjencinë për të ndihmuar në adresimin e sfidave kryesore dhe eksplorimin e mundësive për integrimin e teknologjisë në arsim. Ky bashkëpunim mund të përfshijë diskutime të përbashkëta të *"brainstorming"* me ministrinë dhe institucionet përkatëse për të prioritizuar temat në përputhje me Planin e Veprimit të Agjendës Digjitale për Arsimin dhe analizën e gjendjes aktuale.

Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës mund të mbështesë kërkimin dhe të zhvillojë zgjidhje të mundshme me kontributin e ekspertëve, duke i testuar këto zgjidhje me palët e interesuara nga shkollat dhe IAl. Me mbështetjen politike dhe financiare, zgjidhjet më premtuese mund të zbatohen dhe të përshkallëzohen përmes bashkëpunimit me qeverinë, donatorët dhe sektorin privat.

Krijimi i Agjencisë për Inovacion dhe Ekselencë në Shqipëri krijon një mundësi unike për ministrinë për të bashkëpunuar në fushat më prioritare.

Rezultati i planifikuar:

- Plan i bashkëpunimit strategjik që siguron shpërndarjen në kohë dhe të suksesshme të rezultateve.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- *Zgjidhje të personalizuara për sfidat lokale:* bashkëpunimi do të lehtësojë zhvillimin e zgjidhjeve inovative që adresojnë sfidat arsimore specifike të Shqipërisë.

- *Akses në praktikat më të mira globale:* puna me Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës mund të hapë dyert për kërkime ndërkombëtare dhe praktika të konfirmuara në teknologjinë arsimore.

- *Ndërthurja me sektorin privat dhe partnerët ndërkombëtarë.* Falë mandatit për bashkëpunime të hapura, mund të mundësojë lidhjen me ekspertizë vendase dhe të huaj.

Kutia 6. Agjencitë e Inovacionit në nivel global[14]

Kili dhe Uruguai kanë krijuar agjenci të specializuara inovacioni që integrojnë teknologjinë në arsim, duke përmirësuar përvojat e të mësuarit digjital. Në Kili, Qendra për Inovacionin brenda Ministrisë së Arsimit drejton iniciativa si Plani i Miljes së Fundit për të përmirësuar lidhjen dhe koordinimin e IT-së, me qëllim për të menaxhuar infrastrukturën digjitale në shkolla. Qendra për Inovacionin Arsimor e Uruguait, përqendrohet në nxitjen e inovacionit përmes mjeteve si ALEKS për mësimin e personalizuar të matematikës dhe ndryshimi i dizajnit, i cili fuqizon nxënësit dhe punonjësit arsimorë të zhvillojnë zgjidhje për sfidat arsimore. Të dyja vendet përdorin këto agjenci për të nxitur transformimin digjital dhe për të mbështetur mësimin e shekullit XXI.

21. Organizimi i festivalit kombëtar për arsimin digjital

Në Shqipëri, disa aktorë të sektorit privat kanë kontribuar në nismat e aftësimit digjital. Për

[14] Claro, M., & Jara, I. (2020). Fundi i Enlaces: 25 vjet të një politike arsimore TIK në Kili. *Rishikimi i Arsimit Digjital*, *37*, 96–108. https://doi.org/10.1344/der.2020.37.96-108

shembull, projektet e Vodafone Generation Next dhe Skills Upload Junior[15], si dhe ESEP/eTwinning synojnë të rrisin kapacitetet digjitale të fëmijëve të moshës 12–14 vjeç dhe me gjerë. Ata ofruan trajnime për aftësitë digjitale për nxënësit dhe mësuesit në 80 shkolla deri më tani dhe pritet të shtohen më shumë.

Gjatë pandemisë COVID-19, Ministria e Arsimit bashkëpunoi me Akademi.al me mbështetjen e UNICEF-it për të zhvilluar një portal mësimor në internet *(online)* me videoleksione, vlerësime etj. Ata krijuan mbi 2000 video për të gjitha lëndët për grup-moshat 3–18 vjeç dhe ofruan trajnime për 8000 mësues mbi përdorimin e portalit dhe ofrimin e mësimit *online*.

Megjithatë, angazhimi i sektorit privat mund të rritet veçanërisht në fushën eteknologjive arsimore (Edtech) dhe arsimit digjital. Kjo masë rekomandon krijimin e një aktiviteti digjital të të nxënit që mund të shërbejë si një platformë për mësuesit, sipërmarrësit, inovatorët dhe politikëbërësit për të ndarë praktikat më të mira, për të shfaqur risitë teknologjike dhe për të ndërtuar partneritete.

Festivali do të përfshijë aktivitete të tilla, si ekspozita inovative, diskutime në panel, seminare, hakatone dhe mundësi rrjetëzimi profesional. Pjesëmarrësit do të përfshijnë nxënës, mësues, sipërmarrje të reja në EdTech, investitorë dhe politikëbërës, me partneritete të mundshme nga fondacionet, kompanitë e teknologjisë, telekomunikacioni dhe shkollat e IT-së.

Rezultati i planifikuar:

- Një festival kombëtar i arsimit digjital do të mbahet deri në vitin 2026.

Rezultatet e tjera të mundshme:

- *Promovim i inovacionit dhe bashkëpunimit:* aktiviteti do të krijojë mundësi për ndarjen e njohurive, duke frymëzuar pjesëmarrësit që të adoptojnë teknologji dhe metoda të reja mësimore.

- *Tërheqja e investimeve dhe mbështetja e EdTech:* do të rrisë shikueshmërinë për sipërmarrjet e reja të EdTech, duke tërhequr investime dhe duke inkurajuar zhvillimin e zgjidhjeve lokale.

- Nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar: ngjarja mund të tërheqë interes ndërkombëtar, duke ndihmuar Shqipërinë të lidhet me liderët globalë të EdTech.

Kutia 7. Festivalet EdTech

Disa vende organizojnë konferenca arsimore digjitale për të nxitur bashkëpunimet midis sektorit publik dhe privat dhe për të tërhequr mbështetje nga donatorë. Për shembull, Konferenca EdTech e Belgjikës 2024 promovon bashkëpunimin në të gjithë sektorët me mbështetjen e BE-së, ndërsa konferenca e Sllovenisë "Fuqia e edukimit digjital"[16], e mbështetur nga donatorë privatë dhe Ministria e Arsimit, fokusohet në forcimin e kompetencave digjitale. Në Kazakistan, EdCrunch[17], financuar nga Ministria e Arsimit dhe donatorë privatë, lidh entitetet qeveritare me industrinë EdTech. Këto aktivitete u mundësojnë vendeve të avancojnë iniciativat e edukimit digjital përmes bashkëpunëtorëve strategjikë dhe mundësive të financimit.

22. Krijimi i mekanizmave për njohjen e krediteve të programeve/kurseve specifike Kurse Masive të Hapura *Online* (MOOCs) sipas kërkesës së tregut

Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026 trajton nevojën për përafrim më të mirë mes arsimit të lartë dhe tregut të punës. Një nga objektivat specifikë, objektivi C3, fokusohet në përmirësimin e lidhjes së arsimit të lartë me tregun e punës. Ky objektiv synon të sigurojë që institucionet e arsimit të lartë të ofrojnë programe që janë më të orientuara drejt nevojave të industrisë dhe punës, duke rritur kështu mundësitë për punësim të të diplomuarve.

Kjo masë politike sugjeron përditësimin e akti rregullator për të pranuar kredite nga programe/ Kurse Masive të Hapura *Online* (MOOC) të njohura në fusha me kërkesë të lartë të tregut të punës. Procesi përfshin hartëzimin e nevojave të tregut të punës, duke u konsultuar me institucionet e arsimit të lartë, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim, INSTAT-i etj., për të identifikuar boshllëqet, rishikimin e politikave akademike për të thjeshtuar transferimin dhe vlerësimin e krediteve, si dhe krijimin e bashkëpunimeve me ofrues të

[15] *Ngarkimi i aftësive Jr | Arsimi dhe teknologjia, katalizatorë për ndryshim.* (nd). https://skillsuploadjr.eu/

[16] *Konferenca IZZI – Fuqia e Edukimit Digjital* (nd). https://konferenca.izzirokus.si/en/home/

[17] *Teknologjitë e reja në arsim. Konferenca ndërkombëtare EdCrunch Reload* (nd-b). Rifresko EdCrunch. https://edcrunch.online/en

mirënjohur të MOOC-ve. Këto bashkëpunime do t'u mundësonin studentëve të fitojnë kredite për përmbushjen e Kurseve Masive të Hapura *Online* (MOOC) që plotësojnë kriteret e përcaktuara të cilësisë, veçanërisht në fusha të avancuara si siguria kibernetike dhe inteligjenca artificiale. Kjo qasje u mundëson studentëve të fitojnë aftësi që mund të rrisin mundësitë e tyre të punësimit.

Rezultati i planifikuar:

- Të përcaktohen qartë modelet, sistemet, institucionet dhe modalitetet për njohjen e krediteve për kurset e përzgjedhura në Kurset Masive të Hapura *Online* (MOOC).

Rezultatet e tjera të mundshme:

- *Akses i zgjeruar në arsim cilësor:* studentët fitojnë fleksibilitet dhe akses më të madh në një gamë më të gjerë kursesh, duke zgjeruar aftësitë e tyre.

- *Përputhshmëria me nevojat e tregut të punës:* integrimi i Kurseve Masive të Hapura *Online* në sistemet e krediteve forcon lidhjet ndërmjet programeve arsimore dhe aftësive të kërkuara nga punëdhënësit.

Kutia 8. Kurse *online* për kredite universitare

Shtete si Franca, Austria dhe Koreja e Jugut kanë zhvilluar portalet kombëtare Kurse Masive të Hapura për të zgjeruar aksesin në kurset e nivelit universitar. FUN-MOOC i Francës ofron mbi 550 kurse nga 140 partnerë, iMooX i Austrisë ofron rreth 200 kurse dhe Kurset Masive të Hapura *Online* të Koresë së Jugut ofrojnë mbi 500 kurse TIK. Këto platforma, përgjithësisht falas, ndonjëherë përfshijnë mundësi për të fituar kredite, veçanërisht në Austri dhe Korenë e Jugut. Për më tepër, partneritetet publik-privat, të tilla si bashkëpunimi midis Universitetit Mapúa të Filipineve dhe *Coursera*-s, i lejojnë studentët të fitojnë certifikata të njohura nga tregu i punës në fusha me kërkesa të larta si analiza e të dhënave dhe shërbimet kompjuterike në *Cloud,* duke rritur aksesin dhe punësimin.

Kapitulli 3: Burimet financiare
Periudha indikative: 2025–2030

Kostoja indikative totale	**6 453 400 000 ALL**

* Të gjitha vlerat janë indikative, të bazuara në kosto mesatare njësi nga iniciativa të ngjashme dhe të dhëna të raportuara më parë nga MA-ja. Shumat përfundimtare mund të përmirësohen gjatë përgatitjes së përllogaritjeve të detajuara dhe proceseve të prokurimit.

PLANI I ZBATIMIT – VLERËSIMI I KOSTOS/NDIKIMI NË BUXHET

Nr.	Masat	Parametrat e kostove kryesore	Buxheti i parashikuar në LEK	Burimi i financimit të projektuar	Institucioni zbatues
Objektivi 1. Zgjerimi dhe përmirësimi i infrastrukturës arsimore digjitale					
1	Laboratorë *Smart* (615 shkolla)	654 laboratorë	3,471,500,000	Buxhet i shtetit + CEB +WBIF	AKSHI/MA
2	Blerja e 5,500 laptopëve për mësuesit e gjimnazeve	5500 laptopë	550,000,000	OPI (IPA)	AKSHI/MA
3	Internet me brez të gjerë & Wi-Fi	€4,333 /shkollë	325,000,000	Buxhet i shtetit + donatorë	AKSHI/MA
4	Krijimi i platformës kombëtare qendrore për menaxhimin e të gjithë informacionit kërkimor shkencor në Shqipëri. (ACRIS)	Sistem	200,000,000	Buxhet i shtetit	AKSHI/MA
Objektivi 2. Zhvillimi i standardeve të administrimit dhe të monitorimit të arsimit digjital					
5	Mekanizmi i monitorimit të planit të veprimit	Konsulenca	15,000,000	Buxhet i shtetit	MA/AKSHI
6	Standarde të niveleve të ndryshme për institucionet publike të arsimit të lartë (IAL)	Rishikimi i Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë	5,000,000	Buxhet i shtetit	MA/AKKSHI
7	Treguesit kombëtarë dhe administrimi i të dhënave	Konsulencë + trajnimi	5,000,000	Buxhet i shtetit	AKKSHI/MA
Objektivi 3. Mundësimi dhe inkurajimi në implementimin e teknologjive inovative si IA					
8	Udhëzime dhe pilotime për Gjeneratën-AI	Udhëzues + projekte pilot	2,500,000	Buxhet i shtetit	MA/ASCAP
9	Bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e Teknologjisë së Avancuar	Programe/kurse të përbashkëta	20,000,000	Buxhet i shtetit/donatorë	MA/ASCAP
10	Kurrikula për AI & trajnimet e mësuesve	Zhvillim + trajnim (1,000 mësues)	10,000,000	Buxhet i shtetit/donatorë	MA/ASCAP

Nr.	Masat	Parametrat e kostove kryesore	Buxheti i parashikuar në LEK	Burimi i financimit të projektuar	Institucioni zbatues
Objektivi 4. Rritja dhe mbështetja e aftësive digjitale të mësuesve					
11	Trajnimi TIK për të gjithë mësuesit	16,000 mësues + 10 module	62,400,000	Buxhet i shtetit + donatorë	MA/ASCAP
12	Përditësimi i programeve të studimit të arsimit të lartë për pajisjen me aftësi digjitale në formimin fillestar të mësuesve	Përditësimi i HEQ + workshop	10,000,000	Buxhet i shtetit	MA/ASCAP
13	Mekanizëm *online* për zhvillimin profesional të vazhdueshëm (CPD)	Platforma + përmbajtja	70,000,000	Buxhet i shtetit + donatorë	MA/ASCAP
14	Vazhdim i përmirësimit gjithëpërfshirjes në arsimin digjital	Vlerësimi i nevojave + trajnimi	45,000,000	Buxhet i shtetit + donatorë	MA/ASCAP
Objektivi 5. Promovimi i kurrikulave digjitale të përditësuara dhe gjithëpërfshirëse					
15	Përditësime të kurrikulës TIK (arsimi parauniversitar Kl-12)	Komisioni + pilot	21,000,000	Buxhet i shtetit	MA/ASCAP
16	Edukimi për higjienën digjitale	Design + rollout	1,000,000	Buxhet i shtetit	MA/ASCAP
17	Plani i përdorimit të laboratorëve *Smart*	Udhëzime + kalendari	1,000,000	Buxhet i shtetit	MA/ASCAP
18	Përmbajtje/Kontenti digjital sipas kurrikulës		10,000,000	Buxhet i shtetit + donatorë	MA/ASCAP
Objektivi 6. Inkurajimi i angazhimit shumëpalësh në edukimin digjital					
19	Hartimi i udhërrëfyesit për rritjen e vizibilitetit *online* të IAL-ve dhe shkollave	Konsulencë	8,000,000	Buxhet i shtetit + donatorë	MA/AKKSHI
20	Hartimi i planit të veprimit për bashkëpunim me agjencinë e inovacionit dhe ekselencës	Plani veprimit + planet pilot	7,000,000	Buxhet i shtetit	MA/AKKSHI/AIE
21	Festival Kombëtar për Mësimin Digjital	Aktivitet i përvitshëm	5,000,000	Donatorë + Buxhet i shtetit	MA/AKKSHI
22	Hartimi i udhërrëyesit për njohjen e krediteve nga kurset MOOC	Hartimi i udhërrëfyesit	4,000,000	Buxhet i shtetit + donatorë	MA/AKKSHI
Totali					

MATRICA E REZULTATEVE

Nr.	Rekomandim	Objektivat (produkti i planifikuar)	Rezultatet e planifikuara	Periudha afat-shkurtër	Periudha afat-mesme	Periudha afatgjatë	Kostoja financiare indikative e parashikuar në ALL	Institucioni përgjegjës
1	Zgjerim i laboratorëve inteligjentë (*SmartLabs*) në të gjitha shkollat deri në vitin 2027	Krijimi i laboratorëve inteligjentë (*SmartLabs*) me akses për çdo shkollë	- Raporti i përmirësuar nxënës-për-pajisje - Qasje universale në pajisjet TIK	2026	2027-2028	2029	3,471,500,000	AKSHI/MA
2	Blerja e 5,500 laptopëve për mësuesit e gjimnazeve	Blerja, shpërndarja dhe mundësimi i përdorimit të 5500 laptopëve			2027		550,000,000	AKSHI/MA
3	Vazhdimi me zgjerimin e lidhjes së shpejtë me bandë të gjerë dhe Wi-Fi në të gjitha shkollat	Sigurimi i lidhjes me shpejtësi të lartë (të paktën 30MBits) në të gjitha shkollat	- Akses në internet me shpejtësi të lartë për të gjitha institucionet arsimore dhe integrim i pandërprerë i mësimit digjital	2026	2027-2028	2029	325,000,000	AKSHI/MA
4	Krijimi i platformës kombëtare për menaxhimin e informacionit kërkimor shkencor (ACRIS)	Ngritja e një platforme kombëtare të centralizuar për kërkimin shkencor	Realizim sistemi		2027		200,000,000	AKSHI/MA
5	Krijimi i një mekanizmi për monitorimin dhe mbështetjen e planit të veprimit të agjendës digjitale për arsimin	Miratimi i një mekanizmi monitorues që përfshin monitorim dhe raportim periodik të zbatimit të planit të veprimit	Koordinim qendror efikas për zbatimin e strategjisë dhe politikave dhe programeve e politikave përkatëse	2026			15,000,000	MA/AKSHI
6	Vendosja e standardeve të shkallëzuara për pajisjet digjitale dhe ndërlidhjen në institucionet e arsimit të lartë	Kodi i Cilësisë së Arsimit të lartë përditësohet me kërkesat bazë dhe të avancuara përkatëse të ofrimit të infrastrukturës digjitale bazuar në programet e ofruara	Disponueshmëri e unifikuar e infrastrukturës bazë dhe/ose të avancuar digjitale nëpër institucionet e arsimit të lartë		2027		5,000,000	MA/AKKSHI
7	Finalizimi i treguesve kombëtarë të arsimit dhe miratimi i një strukture të fortë të administrimit të të dhënave arsimore	- Miratimi dhe monitorimi i rregullt i treguesve kombëtarë të arsimit digjital - Miratimi i kuadrit të qeverisjes së të dhënave arsimore	- Kuptimi i hershëm dhe më i mirë i tendencave në arsim dhe aftësia për të marrë vendime të bazuara në të dhëna - Përdorimi i sigurt dhe	2026	2027		5,000,000	AKKSHI/MA

Nr.	Rekomandim	Objektivat (produkti i planifikuar)	Rezultatet e planifikuara	Periudha afat-shkurtër	Periudha afat-mesme	Periudha afatgjatë	Kostoja financiare indikative e parashikuar në ALL	Institucioni përgjegjës
			i përgjegjshëm i të dhënave arsimore					
8	Zhvillimi dhe zbatimi i udhëzuesve dhe i rasteve praktike për përdorimin e IA gjeneruese	- Publikimi i udhëzuesve dhe rasteve përkatëse të përdorimit për IA Gjeneruese - Adoptimi i udhëzuesve në të gjitha institucionet arsimore	- Adoptimi i sigurt dhe i përgjegjshëm i IA në fushat përkatëse të ekosistemit arsimor		2027		2,500,000	MA/ASCAP
9	Zhvillimi i një plani për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për kurset e teknologjisë së avancuar në institucionet e arsimit të lartë	- Krijimi i një kuadri bashkëpunimi ndërkombëtar për kurset e teknologjisë së avancuar dhe të jenë funksionale 2–3 kurse të përbashkëta	- Rritja e aksesit në teknologjinë më të fundit të të mësuarit, duke përmirësuar kapacitetin e fuqisë punëtore dhe nxitjen e inovacionit dhe kërkimit	2026			20,000,000	MA/ASCAP
10	Përfshirja e arsimit mbi IA në kurrikulën e TIK-ut	- Edukimi i IA-së është i integruar në kuadrin e kurrikulës për arsimin parauniversitar	- Rritja e njohurive të IA-së te mësuesit dhe nxënësit	2026	2027		10,000,000	MA/ ASCAP
11	Zgjerimi i trajnimeve në TIK për të gjithë mësuesit dhe ofrimi i mbështetjes për trajnime bazuar në vlerësime periodike	- Miratimi i një aktiviteti për aftësitë bazë të TIK për të gjithë mësuesit	- Të gjithë mësuesit kanë nivele bazë të aftësive digjitale, duke mundësuar kështu adoptimin e pandërprerë të metodave të pedagogjisë digjitale	2026	2027		62,400,000	MA/ASCAP
12	Lidhja e programeve të studimit në fushën e mësuesisë me kompetencat digjitale të kërkuara për mësuesit	Kompetencat digjitale të përfshirë në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë për programet e studimit në fushën e mësuesisë	- Mësuesit e rinj kanë një nivel bazë të aftësive digjitale dhe janë më të përgatitur për të adoptuar metoda dhe mjete digjitale të të mësuarit		2027		10,000,000	MA/ASCAP
13	Përditësimi i mekanizmit *online* të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në për mësuesit	- Mekanizmi i përmirësuar i zhvillimit të vazhduar profesional me bibliotekë të centralizuar të burimeve të trajnimit, trajnime *online* dhe portofol digjital të mësuesve me rrugë të personalizuara të të mësuarit	- Ofrimi i zhvillimit të vazhduar profesional përmes një pikë aksesi të lehtë dhe programeve të dedikuara		2027-2028		70,000,000	MA/ASCAP
14	Vazhdimi i përmirësimit të gjithëpërfshirjes në arsimin digjital	- Një vlerësim i nevojave të teknologjisë mbështetëse në shkolla dhe programe gjithëpërfshirëse të trajnimit të mësuesve	- Përvoja e përmirësuar e të mësuarit për fëmijët nga grupe vulnerabël të popullatës		2027-2028	2029	45,000,000	MA/ASCAP
15	Vazhdimi i përditësimit të kurrikulës dhe kompetencave të TIK-ut për arsimin parauniversitar	- Kurrikula dhe kompetencat e TIK janë përditësuar për të gjitha klasat në nivelin parauniversitar	- Studentët kanë akses në kurrikulën më të fundit të TIK-ut dhe zhvillojnë aftësi të epokës së re	2026			21,000,000	MA/ASCAP
16	Zhvillimi dhe zbatimi i një programi edukimi mbi higjienën digjitale	- Një program edukimi për higjienën digjitale është zhvilluar dhe zbatuar në të gjitha shkollat	- Angazhim i sigurt dhe i përgjegjshëm me mjetet e edukimit digjital	2026	2027		1,000,000	MA/ASCAP
17	Bërja e mundur e përdorimit efektiv të laboratorëve inteligjent (*SmartLabs*)	- Hartimi dhe miratimi i një plani shfrytëzimi për laboratorët inteligjent (*SmartLabs*)	- Shfrytëzimi efektiv i infrastrukturës së re digjitale të laboratorëve inteligjentë	2026	2027		1,000,000	MA/ASCAP
18	Përditësimi i përmbajtjes digjitale sipas kurrikulës së përditësuar	- Zhvillimi digjital i përmbajtjes së mësimit në internet në përputhje me kurrikulën më të fundit dhe krijimi i një mekanizmi institucional për përditësime periodike	- Aksesi digjital në përmbajtjen e mësimit në internet duke e mundësuar mësimin në distancë në çdo kohë dhe kudo	2027			10,000,000	MA/ASCAP
19	Krijimi i një udhërrëfyesi për të rritur shikueshmërinë në internet të institucioneve dhe shkollave të arsimit të lartë	- Miratimi dhe zbatimi i udhërrëfyesit	- Disponueshmëri e lehtë e të gjithë informacionit përkatës *online* në lidhje me IAL-të dhe shkollat	2026	2027		8,000,000	MA/AKKSHI

Nr.	Rekomandim	Objektivat (produkti i planifikuar)	Rezultatet e planifikuara	Periudha afat-shkurtër	Periudha afat-mesme	Periudha afatgjatë	Kostoja financiare indikative e parashikuar në ALL	Institucioni përgjegjës
20	Bashkëpunimi me Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës për përdorimin e teknologjisë në arsim	Plani strategjik i bashkëpunimit që siguron rezultate në kohë dhe të suksesshme	- Zgjidhje inovative për përdorimin e teknologjisë në arsim	2026	2027		7,000,000	MA/AKKSHI
21	Organizimi i festivalit të mësimit digjital në Shqipëri	- Mbajtja një festivali vjetor mbi mësimin digjital	- Përmirësimi i angazhimit midis grupeve të interesit të arsimit digjital dhe EdTech, duke mundësuar inovacion, bashkëpunim dhe investime		2027		5,000,000	MA/AKKSHI
22	Njohja e krediteve për disa Kurse Masive të Hapura *Online* (MOOCs), sipas kërkesës së tregut	- Kurset Masive të Hapura *Online* (MOOCs) njihen zyrtarisht me kredite për disa kurse të përzgjedhura	- Akses në kurset me kërkesë të lartë në tregun e punës		2028–2029		4,000,000	MA/AKKSHI

SHKURTESA

Shkurtesa	Formulimi i plotë
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar i Emergjencës për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
AADF	Fondi Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit
OSFA	Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
KE	Këshilli i Evropës
MA	Ministria e Arsimit
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
RASH	Qendra e Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar
SMIP	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar
SMIAL	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Institucionet e Arsimit të Lartë
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar
AKAP	Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar
ASCAL	Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë
DRAP	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
ZVAP	Zyrat Vendore Arsimore Parauniversitare
QSHA	Qendra e Shërbimeve Arsimore
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve
IAL	Institucionet e arsimit të lartë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/12/10 13:21:50 +02'00'
eea390d1154f4ba2a57e0efa2a4da1bb

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)